

INTERVISTË ME IBISH NEZIRIN

Prishtinë | Data: 5 mars, 2016

Kohëzgjatja: 121 minuta

Të pranishëm:

1. Ibish Neziri (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Noar Sahiti (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional {} - e intervistuar shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkript:
[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin.
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

Pjesa e parë

[Intervistuesja kërkon nga folësi të prezantohet dhe të flas për rrethin ku është rritur. Pyetja është prerë nga video intervista.]

Ibish Neziri: Unë jam Ibish Neziri. Zyrtarisht quhem Neziraj po kurrë në jetën teme se kam quajtur ndryshe vetën teme pos Neziri. Jam i lindur në korrik të vitit 1957, në fshatin Bardhaniq, një fshat që përafërsisht, plus minus, i bjen t'i ketë njësoj larg Gjakovës, Deçanin dhe Klinën. Është një zonë malore, krejt mes pyjesh atje. Gjatë gjithë historisë njihet si vend liridashës si vend që ka dhënë kontributin e vet për liri qoftë në mbajtjen, ruajtjen, strehimin e luftëtarëve nga Lëvizjet Kaçake e deri tek ushtarët e luftës së fundit, ushtarët e UÇK dhe gjatë luftës së fundit ka qenë zonë e UÇK-së.

Unë kam lindur në at' fshat, në një familje relativisht të madhe. Familja ka qenë rreth nëndhjetë anëtarëshe kur kam lindur unë dhe në moshën e fëmijërisë jemi ndarë nga ajo bashkësi e madhe familjare dhe kam jetuar me babën, me vëllezërit dhe motrat. Baba ka jetuar 103 vjet, nëna ka jetuar 86 vjet dhe unë aty e kam kry shkollën fillore dhe pastaj gjimnazin e kam përfunduar në Pejë dhe kam studjuar për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe deri në vitin 1980. Në vitin 1980 jam burgosë për shkak të aktivitetit tim, të veprimtarive të mia në organizatën ilegale, që ajo është quajtur atë kohë Fronti i Kuq Popullor. Qendrën e ka pasur në Bohum të Gjermanisë. Me rastin e arrestimit më janë zënë disa libra, më janë zënë disa afisha, të cilat ishin të gatshme të shpërndahen për festën e flamurit.

Erëmirë Krasniqi: Ku e bëjshit këtë aktivitet?

Ibish Neziri: Po, aktivitetin ne u përpoqëm ta... bënim në gjithë Kosovën, afishet t'i shpërndanim në gjithë Kosovën. Ndërkaq grupi ishte, grupi, organi... dega grupit ose dega e organizatës së Frontit të Kuq Popullor ishte në Pejë. Ajo ka pasur edhe degë të tjera për të cilat ne faktikisht nuk kemi pas kontakte për shkak të ilegalitetit, për shkak të fshehtësisë, por ne jemi përpjekur që aksionin ta kryenim në Pejë, por edhe në Prishtinë, mirëpo jemi penguar sepse me 19 nëntor unë u arrestova dhe...

Erëmirë Krasniqi: Qysh jeni përfshi fillimisht, qysh jeni përfshi në këtë aktivitet politik?

Ibish Neziri: Unë thashë se kam lind në një fshat, i cili gjithmonë ka qenë fshat liridashës, vend ku ka

strehue, ku i ka mbajtur luftëtarët e lirisë, ata kanë qëndruar gjatë edhe në shtëpinë e babait tim. Unë jam rritur përmes atyre tregimeve, jam rritur përmes atyre historive të dëgjura nga babai im dhe miqtë e tij të cilët e vizitonin shpesh, po edhe nga rrëfimet në anën tjetër edhe të nanës time, e cila tregonte se si u ka përgaditur ushqimin, si kanë ardhë, si kanë hy, si kanë dal. Për shumë rrëfime që i kanë pasë, dhe në këtë rast s'mund të mos ua tregoj edhe një ngjarje që shpesh i lenë edhe atë anën qesharake, e ka edhe atë anën e vet qesharake...

Axha i... Shkoj ma konkretisht. Mehmet Agë Rrashkoci është axha i babës së Presidentës së tanishme¹. Ai ka qenë njëri ndër ta, pastaj Demë Ali Pozhari, Ramë Binaku i Dashinocit, ka pasë edhe kaçakë të tjerë, po iu them ashtu siç iu kanë thënë edhe pleqët, të cilët kanë qëndruar gjatë në shtëpinë tonë. Dhe në një rast ata ishin n'shtëpinë tonë. Fundi i luftës. Brigada e Bokës, Bokelska Brigada, e rrethon fshatin, i mbledh gjithë njerëzit përpara shtëpisë së babait tim, ndërkohë që ata ishin strehuar në shtëpi, dhe kaçakët, kjo ndodhë dikun nga viti '45, fillimi i '45-tës duhet të jetë, viti '45, "Halil, ku janë kaçakët? Ku janë kaçakët?" E shtrengojnë fshatin me i qitë kaçakët, dhe plaku u thotë... edhe plaku thotë, "More, po... shok Vuçk po, ju fshatin e keni mbledhë kot, ju kot e keni grumbullu fshatin, po kta s'kanë bukë me hangër vet e le më për kaçakë. Kaçakët nuk hajnë gjithçka, ata dojnë mish e pite, e këtu..." thotë, "veç dy vetë i majnë kaçakët." "Kush i man kaçakt?" "Kaçakët i maj unë edhe t'i man qeky plaku." Një plak i lodhur, me një shkop i mbështetur. Kur thotë, "I maj unë dhe i man ky plaku," ai plaku e çon shkopin me i ra e thotë, "Mos fol! Pse po fol Halil?" Dhe don t'i bie shkop, edhe kjo kalon pastaj në një qeshje të përgjithshme, dhe ata thonë, "Ik, se s'ka gjë".

Herën tjetër shkojnë e futën në odë, "Halil, a din ku janë kaçakët?" Thotë, "Po." "Ku janë?" "Po, kurrë ma afër nuk i ke pasë." "Si more kurrë ma afër?" "Po. Kurrë ma afër nuk i ke pasë." Thotë, "Mos bon hajgare!" "Po ju kallxoj drejt". E vërteta ishte se ata ishin në anën tjetër të murit, do të thotë vetëm një muri i ndante me... me ushtarët e Jugosllavisë kaçakët. Kështu që unë jam rritur përmes atyre tregimeve. Kjo ishte njëri ndër faktorët, ky ishte njëri ndër faktorët që kanë ndiku në krijimin tim. Pastaj janë ato librat e Rilindasëve Naimi me, "O malet e Shqipërisë" e ku ta di unë gjithë ato libra, gjithë ato që janë shkruar, e libra tjera që kanë ardhë nga Tirana, të cilat ne sot i mohojmë padrejtësisht, sepse ç'është e vërteta ne me libra të tyre jemi rritur dhe jemi edukuar, kështu që ky ka qenë edhe ai formimi im.

Pastaj është edhe një tregim tjetër për një mësues nga Shqipëria, i cili ka qenë në zonën tonë dhe kur... tregonte babai për te, kur janë largu mësuesit pas prishjes së marrëdhënieve Jugosllavi-Shqipëri, babait tim ia lenë amanet, i thotë "Ndihmoje arsimin sa të munesh! Ndihmoje arsimin, se pa arritë arsimimi kulmin kurrë Kosova nuk ka me dalë," siç thonte babai im, "prej shkaut." Po thotë, "Kur del arsimi, kur arrin arsimimi kulmin," thotë, "atëherë kur babai punon në polici, fëmija në shkollë dhe në mbramje kur takohen në shtëpi, fëmija nuk i tregon babait çfarë ka mësuar në shkollë," thotë, "atëherë e arrin kulmin". Dhe babai im e ka mbështet arsimin jashtëzakonisht shumë. Kur them e ka

¹ Intervista është realizuar në kohën kur Atifete Jahjaga, mars 2016.

mbështetur arsimin, unë them nga ky aspekt: Mësuesit kanë ardhur nga Gjakova kanë ardhur nga rrethi i Pejës, do të thotë kanë ardhur [nga] larg dhe ai shpeshherë më thonte, “Dil në kodër të fshatit, shih a ka dritë në shkollë, a jo?” Dhe nëse kishte dritë në shkollë do të thonte se mësuesit ishin në shkollë s’kishin mundur të ktheheshin, sepse s’kishte ndonjë lidhje tjetër pos udhëtimit në këmbë dhe udhëtimi në këmbë zgjaste tri-katër orë. Çonte njërin nga vëllezërit e mij dhe i merrte mësuesit, nuk i linte në shkollë. Do të thotë, më shumë dimrit i ka mbajtur në shpi të vet sesa kanë nejt mësuesit, kanë qëndruar në shtëpitë e tyre dhe të gjitha këto kanë ndikuar në formimin tim, kanë zgju interesimin për hulumtime të mëtutjeshme, për të mësuar më shumë dhe kështu ka ndodhur, do të thotë, ajo rruga e krijimit tim.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka ndodhë me... te burgosja, qysh ka ardhë deri aty?

Ibish Neziri: Sa jam informu, ende konkretisht nuk e di. Sa jam informu, një shok i yni i cili vinte nga Gjermania me porosi për tek ne, është burgosur, është mbajtur dy-tre ditë, është liruar dhe duket se përmes tij jemi dekonspiru. Shumë vonë e kam marrë vesh nga një intervistë e tij që ai është burgosur në atë kohë në të... ‘80-tën. Dhe... ai duket se, duket të ketë qenë i përcjellur... duket të ketë qenë i përcjellur dhe në takimin me mu pastaj përcjellja është zgjeru dhe unë kam fillu tëurvejohem, t’përcillem nga sigurimi i shtetit, i cili atë emrin taman origjinal e ka pasë UDB... dhe në nëntor të ‘80-tës derisa përgadishim aksionin, unë jam burgosë. Atë kohë jemi denu dy persona. Jemi denuar për propagandë armiqësore nga neni famoz i vitit një mijë e nënqind e... m’fal! Jam denuar për propagandë armiqësore nga neni 133 i Ligjit Penal të Jugosllavisë i cili ishte një, një... ligj ose një nen famëkeq i ligjit penal, sepse njeriu denohej edhe për shkak të mendimit, do të thotë as për të menduar nuk guxonte dhe me atë nen jam denuar. Jam denuar me dy vjet burg, ndërkaq ai shok që ka ardhë nga Gjermania është denuar me një vit e gjysmë burg. Janë denuar edhe dy të tjerë, nga rrethi i Gjakovës dhe kështu kemi mbetur në burg.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na...

Ibish Neziri: ... gjithsej katër vetë, por pa qenë në lidhje, do të thotë, pa mundur të na venin në lidhje me njëri-tjetrin në aktakuzë dhe përpjekja e tyre për ta formuar këtë grup prej ne të katërve ka dështuar dhe jemi denuar që të dy palët, dy-dy, jemi denuar me neni 133.

Erëmirë Krasniqi: Kjo me siguri ka qenë e randsishme për me iu denu si grup për me konstrukt një rast ma të madh?

Ibish Neziri: Për denime po. Për denime ma të...

Erëmirë Krasniqi: Po, a kishit mujt me na ndërto nifarë historie t’qesaj iniciative politike? Mendoj, qysh ka fillu? Kush, qysh keni fillu ju m’u angazhu në të? E organizume prej kujt? Çfarë lloj ideale?

Ibish Neziri: Po kjo ka qenë pjesë e Frontit të Kuq Popullor. Atëherë nuk është dashtë shumë të ketë dikush që ta organizoj dikë tjetër. Fillimisht, do të thotë ka mjaftuar kontakti me literaturën, kontakti me programin, me statutin e organizatës dhe shokët e kanë gjetë shokun. Do të thotë, për pa pasë një lidhje, një diçka që afron shokët mes vete ka qenë e vështirë të bashkohen shokët, parandaj do të thotë kjo ka qenë, “Qe e kam marrë një libër të mirë,” apo “m’ka ra ndorë një program, ishte interesant, qe lexoje. A qenka i mirë, a po bëmë diçka?” Në këtë mënyrë ka shku ajo rruga e krijimit të grupeve dhe organizatave. Të paktën flas për grupin tim në këtë rast.

Erëmirë Krasniqi: Kush ka qenë... po, nëse mundeni me na tregu kush ka qenë në grup?

Ibish Neziri: Kush ka qenë në grup a po? Po, unë dhe Malush Ademi jemi burgosur herën e parë, do të thotë Malush Ademi dhe unë. Malushi ka qenë në Gjermani edhe unë kam qenë këtu. Ne jemi burgosur së pari. Janë marrë në të ‘80-tën... janë marrë në pyetje edhe dy apo tre tjerë, të cilët, do të thotë, kanë pasë kontakt me neve edhe ju ka ra në sy kontakti me neve. Kjo është sa ka t’baj me denimin e parë. Mu atëherë më është zënë një trakt që edhe sot e kësaj dite përmendsh ia di përmbajten atij traktit dhe unë tani edhe po e them, “Armiku ynë shekullor, titzmi Jugosllav po i mbush burgjet me patriotë shqiptarë, por le të dijë se nuk do të na frigoj dhe nuk do të na largoj dot nga lufta e shenjtë për çlirim nacional dhe social si dhe për bashkim me vendin amë Shqipërinë socialiste. Rroftë populli shiptar! Rroftë partia e punës... Rroftë Shqipëria! Rroftë Partia e Punës së Shqipërisë në krye me shokun Enver Hoxha!”

Kjo ka qenë përmbajta e traktit me të cilin edhe jemi arrestu. Ka qenë një copë kartë dhetë me dhetë centimetra, letër e kuqe e shkruar me ngjyrë të zezë dhe vetëngjitëse, vetëm i heqej ajo folia nga mrapa dhe ngjitej kudo. Kjo ishte ajo, ajo... t’i them afishe, trakt.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet i keni pasë kur jeni burgosë?

Ibish Neziri: Po llogarisim tash. Unë jam burgosë... i lindur me 24 korrik ‘57, i burgosur 19 nëndor ‘80 do të thotë 23 vjet. 23 vjet kam pasë kur jam arrestruar. E pastaj në pranverën e vitit ‘81... ndodhën gjëra tjera. Jugosllavisë përfundimisht fillun t’i rrënohen themelet po këtu në Prishtinë ku edhe po e bajmë intervistën. Me 11 mars filluan demonstratat...

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë pjesë e tyre?

Ibish Neziri: Po unë s’mund t’them që kam qenë derisa unë isha n’burg, t’paktën jo pjesë direkte, po mund të them që edhe... nuk ka pasë, do të thotë edhe ndikimi nuk ka qenë jo prezent, edhe ndikimi im edhe i organizatës me të cilën kemi vepru, do të thotë edhe ata kanë ndikuar, ka ndikuar edhe vet gjendja e krijuar në Kosovë, vet rrethanat e krijuara në Kosovë. Në Kosovë pas shënimit të 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit ndodhi një ndryshim i qind për qindt. Populli u entuziazmue, do të thotë ... dhe... filloi t’i sheh gjërat më ndryshe, filloi ta kuptoj lirinë më ndryshe, filloi ta sheh se... vet liria është të kuptuarit e domosdoshmërisë dhe domosdoshmëria ishte që Kosova përfundimisht të lirohej prej

Serbie. Edhe kjo do të thotë ishte. Ato ngjarje sollën rrethana t'reja, sollën burgosje t'reja edhe... Ishte dikush që nuk mundi t'shkoj deri n'fund. Dikush që nuk mund qëndroj deri në fund dhe emri im përsëri u lakua nëpër rasa.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, protesta e '81-shit kanë afektu edhe gjendjen e qëndrimit tënd n'burg? A ju ka pru ajo...

Ibish Neziri: A më ka penguar?

Erëmirë Krasniqi: E ka afektu po mendoj... a jeni dyshtu prap? A janë... mundu me ju lidhë me grupet tjera?

Ibish Neziri: Po, fillimisht, fillimisht jo. Unë përsëri... kanë filluar përsëri... Unë jam marrë në pyetje pas arrestimit të një grupit nga Gjakova. Unë jam marrë në pyetje, jam marrë në pyetje njëherë për... Do të thotë dikush atje ka përfolë emrin tim... dhe nuk e ka përfolur krejt kot dhe krejt rastësisht. Pastaj, ka pasë edhe të tjerë që janë arrestuar dhe edhe dikush tjetër e ka përfol emrin tim. Është lakuar emri im nëpër rasa, "Prej kuj?" "Prej Ibishit." "Nga kush?" "Nga Ibishi". Unë vetë paraprakisht kam qenë dy... dy vera para se të arrestohem, dy verat e fundit para se të arrestohem unë kam qenë vet, kam shkuar gjurmëve, ose me qëllim të krijimit të lidhjeve me organizatat ilegale që kanë vepruar në Evropën Perëndimore. Në vitin 1978, kam shkuar në Zvicër por jam kthyer pa ndonjë lidhje dhe në vitin 1979 kam shkuar në Gjermani dhe nga atje unë kam sjellur literaturë të bollshme. Kam sjellur libra, kam gazeta, revista të ndryshme të cilat pastaj kanë kaluar dorë më dorë, të cilat janë lexu...

Erëmirë Krasniqi: Çka kanë përmbajtë?

Ibish Neziri: Po... përmbajtje? Kuptohet se çfarë përmbajtje, po për shembull, "Lëvizja Patriotike e Kosovës dhe Hasan Prishtina", "Kosova Djep i Shqiptarizms", Fjalimi i Ramiz Alisë për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në njëqind vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pastaj gazeta "Shqipëria e Re", "Zëri i Popullit", disa numra, pastaj "Lahuta e Malësisë" e Gjergj Fishtës. Ishte "Tradhëtia" e Kapllan Resulit, një libër që faktikisht është i vjedhur libri, autorisa është e vjedhur, sepse Kapllani nuk është autor i librit. Katërciprisht vërtetuar, po një libër e cila ka kaluar dorë më dorë dhe e cila ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm te rinia e asaj kohe. Ka pasë libra të Enver Hoxhës, ka pasë libra të Enver Hoxhës, sidomos "Vepra e Shtatë", e cila ka të bëjë jashtëzakonisht shumë me Kosovën, me ato relacionet që Enver Hoxha apo Komiteti Qëndror i Partisë Punës Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë ia dërgon përfaqësuesve të vetë diplomatikë, të cilët i ka dërguar në Kombet e Bashkuara, sidomos Mehmet Shehut e të tjerëve, çfarë qëndrimi duhet të mbajnë dhe çfarë duhet të flitet atje, çfarë të thuhet për Kosovën, dhe madje m'kujtohet mirë një shprehje, aty thotë, "Rregulloja mirë samarin atij revizionistit të Beogradit"! Ishte fjala për Titon, ndreqja mirë samarin në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që mbahet çdo vit edhe sot e kësaj dite. E këto kanë qenë ato librat, libra të cilat faktikisht kanë folur shumë për Kosovën, kanë folur për arrestimet, sepse në Kosovë

gjithnji ka pasë arrestime, anipse ato kanë shkuar në heshtje.

Adem Demaçi ishte burgosur për... në vitin 1975 ishte burgosur për herë të tretë me sa e sa intelektualë të rinjë. Metush Krasniqi po ashtu, Kadri Osmani, Xhafer Shatri, dhe... do të thotë, kishte shumë të burgosur të tjerë edhe ato gjithmonë i kanë aktualizu këto çështje nëpër libra dhe nëpër gjëra të ndryshme, revista të ndryshme, apo botime edhe të veçanta. Prandaj edhe, do të thotë, ishin këto që kanë kaluar dorë më dorë, libra të cilët e paraqitnin atë nevojën e krijimit të Republikës së Kosovës, të republikës së shtatë në Jugosllavi, krijimin e Republikës së Kosovës, për të cilën, do të thotë, unë edhe sot e kësaj dite nuk e mendoj se duhet të jetë, sepse projekti i shqiptarëve nuk ka qenë as atëherë në kohën e ilegalitetit kur unë kam vepruar dhe kanë vepruar shumë shokë të mij, nuk ka qenë projekt Kosova Republikë, Kosova shtet i pavarur, por ka qenë projekt bashkimi i... nevojshem dhe bashkimi, do të thotë, i drejtë i territoreve shqiptare në një shtet të veçantë sepse nuk janë shumë vjet që... për historinë të paktën, që trojet tona janë nda dhe janë okupuar... dhe këto ishin ato...

Erëmirë Krasniqi: Qysh...

Ibish Neziri: ... këto ishin ato që kanë bërë që ne të angazhohemi, të organizohemi, anipse gjithmonë është gjetë një pretekst, ta zëmë 28 nëntori, hajde po e shënojmë në këtë mënyrë 28 nëntorin ose ja po protestojmë po fillojmë protestën për ushqim, siç ka ndodh me 11 mars, por që në prapavi nuk ka qenë çështja tek ushqimi por ishte çështja tek...

Erëmirë Krasniqi: Protesta në menzë...

Ibish Neziri: Urdhëroni?

Erëmirë Krasniqi: ... Ushqimi në menzë qysh është marrë si pretekst, a mund të na shpjegoni?

Ibish Neziri: ... po ajo është marrë si pretekst gjoja se është ushqimi i keq, gjoja se ushqimi i dobët i keq e pritjet e gjata në menzë, e ku ta di unë. Unë në atë kohë kam qenë i burgosur do të thotë, por po e paramendoj, por edhe nga bisedat me shokë tjerë, po ajo në prapavi [ka] qenë... fillimi, qëllimi... fillimi i qëllimit demonstratave, kundër pushtimit të Kosovës, kundër mbajtës së Kosovës nën okupim.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë qëndrimi ju në burg gjatë qasaj kohe?

Ibish Neziri: Qëndrimi im në burg gjatë qasaj kohe? Po të flasim për periudhën e hetuesisë, është një periudhë e tmerrshme. Në hetuesi ushtrohen tortura që njeriu,... mendja e shëndoshë e njeriut nuk mund t'i akceptoj, që mund të ia kalojnë edhe Gestapos së Hitlerit, që mund t'i kalojnë edhe atyne hetuesve të Stalinit në Bashkimin Sovjetik. Torturat që janë ushtruar mbi të rinjtë e Kosovës dhe pyetjet janë "Kush? Me cilin? Ku?" Dhe gjana të tilla. Do të thotë gjithmonë ju ka interesue, t'i krijojnë, t'i krijojnë lidhjet dhe të zgjerojnë rrethin e njerëzve që burgosen. Ata e kanë pas një metodë t'vëçantë.

T'kanë folë, t'kanë thanë që, "E, e ke ba këtë, këtë, këtë, këtë", do të thotë ata e kanë saju veprën që gjoja ti e ke bërë dhe... ti ke thënë, "Jo, nuk e kam bërë." E ke mohuar atë, ata pastaj kanë ushtruar tortura të tilla të tmerrme që s'mund t'paramendohen. Dhe përsëri e kanë përsëritur të njëjtën gjë, "Ti e ke bërë këtë, këtë, këtë, këtë", dhe përsëri ka filluar tortura, do të thotë, pas mohimit tuaj dhe i kanë sjell njerëzit në atë gjendje që pastaj ata për t'i ikur torturës, "Çka ke ba, a po fol, a po ja nisim përsëri?" Dhe pastaj ata, ato, ato që i kishte dëgjuar prej hetuesit apo prej hetuesve i ka përsëritur, i ka përsëritur, do të thotë, "...po, e kam bërë këtë, këtë, këtë, këtë", dhe kjo ka ndodhur vetëm për t'i ikur torturës, për t'iu shmangur dajakut dhe me të dalë në gjyq i kanë mohuar ato gjëra, mirëpo gjyqi, faktikisht gjyqet jugosllave asgjë nuk kanë marrë parasysh. Për gjyqet jugosllave kanë mjaftu akuzat e ngritura nga UDB-ja e... Jugosllavisë.

Unë me këtë rast nuk mund të mos e përmend një shembull konkret të studiuar mirë. Për të vërtetuar, këtë mund ta gjeni në librin, "Këtu jam për ti luftuar armiqët monogarfi për dëshmorin e kombit Xhemail Fetahaj". Ai është burgosur si shtatëmbëdhjetëvjeçar, si shtatë.. do të thotë para moshës shtatëmbëdhjetë vjeçare ka përfunduar aktivitetin e tij, dhe e ka përfunduar vetëm dhjetë ditë para se të përfundojë lufta meqë nga afërsia, duke luftuar nga afërsia në llogoret serbe, ishte futur në llogoret e ushtrisë serbe dhe aty u vra. Ai njeri... do të thotë, unë i kam patur në dorë leterkëmbimin i cili është n'libër, i futur n'libër, në mes të sigurimit t'shtetit, gjyqtarit hetues dhe prokurorit. Do të thotë leterkëmbimi n'trekëndësh, duke i dhënë instruksione njëri tjetrit se si të vepronin në rastin e Xhemail Fetahajt. Do të thotë, është dokumentacion i publikuar. Edhe me faksimil është i publikuar në libër. E kjo ka qenë ajo metoda e tyre.

Unë në atë kohë, do të thotë pas hetimeve, i burgosur në nëntor, në mars, më 22 dhe 23 mars, me 22 mars jam nxjerrë para gjykatës, me 22 mars të vitit 1981, do të thotë dhjetë ditë pas fillimit të demonstrateve në Prishtinë, dhe jam denuar me dy vjet n'bur... dy vjet burg, ndërkaq në gusht filluan përsëri hetimet tjera, përsëri.... Jo këtë herë me dy vet, këtë herë grupi u saju prej trembdhjetë vetëve, përfshirë edhe mua. Dhe përsëri e njëjta procedurë e hetimeve, e njëjta procedurë e hetuesisë që zgjati poashtu nga gushti deri në shkurt të vitit 1982 dhe herën e dytë u denova me denim prej, unik, do të thotë, denimi i parë plus denimi i dytë ishte denimi prej gjashtë vjetësh, si udhëheqës i grupit Fronti Kuq Popullor për rrethin e Pejës.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë tash e bonën njëfarë lidhje mes të burgosurve të rinj dhe juve?

Ibish Neziri: Po, dhe meje...?

Erëmirë Krasniqi: Qashtu...

Ibish Neziri: U bë një lidhje përmes t'burgosurve të rinjë dhe meje dhe doli, do të thotë, grupi Fronti i Kuq Popullor për rrethinën e Pejës, për shkak të cilit si udhëheqës mora denimin prej gjashtë vjetësh dhe... edhe këtë rast unë... sepse sigurisht ju interesojnë detajet, dhe unë e përmendi këtë rast, unë u

denova me... n'shkurt u denova. Tri ditë zgjati gjykimi. Në mars, me 17 mars vdiq babai im n'moshën 103 vjeçare. Unë mora vesh në një vizitë të jashtëzakonshme, sepse vizitat e zakonshme ishin me një dhe me 15 të muajit, një vizitë që zgjaste pesë minuta, nuk zgjaste më shumë dhe ajo ishte mes grilash, do të thotë, grilat i kishim n'mes, një rrjetë t'metaltë që as gishtin nuk mund e fusje n'mes vrimash të rrjetës për, për ta prekur gishtin ta zëmë nana apo motra kur vinin në vizitë dhe në një vizitë të jashtëzakonshme prej tre minutash, do të thotë, sa arriti vëllai t'më komunikonte lajmin për vdekjen e babës, kaq zgjati vizita dhe mua ma ndërprente vizitën, dhe jo atë ditë por të nesërmën vetëm për t'më thyer shpirtishtë mu më futën në birucë. Do të thotë biruca ishte një dhomë e vogël, vetëm ti pa njeri, pa... do të thotë që... mbase kur në një rast të tillë njeriu ka nevojë t'i këmbëj dy-tri llafe me dikënd, do të thotë, krejtësisht i vetmuar dhe ajo bahej vetëm për t'më thyer shpirtërishtë. Ajo ishte bërë me urdhër nga lartë dhe urdhëri nga lartë ishte urdhëri nga sigurimi i shtetit.

Hetimet mua m'i kanë udhëhequr... do të thotë, hetimet ndaj meje janë udhëhequr nga Slavković Milim... Milivoje, zavendës i shefit t'sigurimit për Kosovë dhe Asllan Sllamniki, një kriminel se për Slavkovićin unë nuk befasoheja se ishte një kriminel i till, por një kriminel, një shqipfolës siç ishte Asllan Sllamniki, një kriminel i cili n'hetuesi vinte më thonte... me ca durë t'leshta si, si, si një gorillë, vinte më thonte, "Ti sallatë për drekë nuk ke për të më dalë. A e din ti sa njeriut i ka dalë bari mbi trup, sa njeriut i ka dalë bari mbi vorr prej këtyre durëve", dhe mi tregonte ato duar {shpjegon me gjeste si ka mbajtur duart}, mi tregonte ato duar kështu, "ti sallatë për drekë mu nuk m'del, sallatë për drekë nuk m'del". M'mlidhte mirë, m'gozhdonte mirë, mi hiqte syzat dhe pastaj m'dërrmonte... Kështu... dhe ata kur kanë ardhë herën e parë n'gusht... që të dytë se edhe herën e parë edhe herën e dytë i kanë kryer hetimet, po kur kanë ardhur për hetimet e dyta, n'gusht të '92-shit, m'falni n'gusht të '91-shit [duhet të jetë '81-shit, kjo pjesë është shtuar me kërkesën e të intervistuarit], m'thotë Slavković Milivoje, "Gde si mi lbish Neziri? U novembar prevario si me ali dajem ti reč da ne možeš više. Ne možeš više da me prevariš." [Ku t'kam lbish Neziri? Në nëntor më ke mashtruar, por ta jap fjalën se nuk do të mundesh më. Nuk do të mundesh më.] dhe, do të thotë, nga këtu fillon përsëri seria e dytë e hetimeve dhe pason denimi prej gjashtë vjetësh burg.

Qëndrimi im në vetmi në Pejë ishte qëndrim prej një jave. Nëse flasim për gardianët e burgut të Pejës, me përjashtim, dy-tre tjerë, unë edhe sot e kësaj dite kam një respekt t'jashtëzakon... t'jashtë... jashtëzakonisht t'madh për ta, një respekt të jashtëzakonshëm, sepse vërtetë e kanë merituar respektin. Na kanë trajtuar për aq sa ata kanë guxuar, për aq sa ata kanë pasur hapsirë, na kanë trajtuar jashtë... jashtëzakonisht mirë. Dy-tre tjerë kanë qenë t'indentifikuar me kambë e me kry me UDB-në. Dhe në atë kohë n'burgun e Pejës ishte një drejtori e dhunshme, ishte një drejtori e dhunshme dhe një gardian i cili nuk jeton më, një gardian i cili ka mbajtur kontakte me meje dhe shokëve mrenda burgut, i quajtur Bilall Përgjegjaj, ai shkon dhe alarmon drejtorin e burgut, i thotë, "Kemi njeriun që që një javë ditë nuk ka ngranë bukë", edhe vie drejtori i burgut në ora nëntë n'mbrëmje tek unë dhe kërkon llogari se pse s'kam ngrënë bukë dhe detyrohem t'i tham, "Hajt, hiqmu qafesh, hiqmu qafe, hiqmu syshë! Nuk t'kam shpallë grevë urije sepse po t'shpallë grevë urije unë do t'njoftoja, por s'kam shpallë grevë urije dhe hiqmu syshë!" Dhe ai largohet me atë mallkimin, "Kurrë

n'gojë mos t'raftë!"

Dhe pas dy ditësh mua bashkë edhe me njëzet e gjashtë tjerë nga burgu i Pejës... ku i kishin sjellur dy a tre nga Prizreni, dy a tre nga Mitrovica, na nisemi me një autobus drejt Zagrebit. Për neve ishte drejtimi i panjohur. Ne nuk dinim se ku jemi. Fare rastësisht me një vend ku i... me kërkesën e disa t'burgosurve është nalë autobusi për shkaqe do të thotë, për shkak të nevojave fiziologjike është nalë autobusi. E kam pa një pllakatë. Shkrunte, "Nova Gradiška." Atëherë e kam marrë me mend se jam në... jemi në Kroaci dhe na kanë dërguar në burgun e Zagrebit, në Petrinska shtatë. Një burg... si mrenda, si jashtë i tmerrshëm, por aty nuk na kanë mbajtur gjatë, na kanë mbajtur tre-katër orë dhe nga aty me një furgon, të lidhur me zingjirë, të lidhur me zingjirë dhe me dryna, të cilët shumë shpejt sharruan në mish, ngase duart u ajën, na futën ni ni ni autofrigorifer, na futën dhe na dërgun përsëri, për neve në drejtim të panjohur, dhe tek pas një jave kemi marrë vesh se ku jemi.

Kur na fusin në oborrin e një burgu, në të katër anët ndërtesa dhe na pshtetën për mur, njëri nga shokët e mi me të cilin isha i dënuar dhe i cili ishte afër meje, ishte më i ri se unë, thotë, "Po dojnë me na pushkatu", sepse i pau të gjithë t'armatosur, me qenë dhe me armë n'gjendje gadishmërie. U trishtu ai njeri. I them, "Jo, jo, mos ke dert", ndërkaq kur u hap dera para se ne t'dilnim nga aty, drejtori i burgut thotë, Mile Spolarić po ashtu një kriminel i... i... i... kriminel i... i tmerrshëm, thotë, "Je li, ovi su patrioti Envera Hoxha, je li?" [Këta janë patriotat e Enver Hoxhës, këta?] do të thotë, n'këtë mënyrë dhe na mbështetën për muri. Dhe aty unë kam qëndruar më së gjati n'mesin e atyre të burgosurve. Para nesh e kishin dërgu edhe një grup tjetër dhe kishe filluar transferi i aty... i atyre, i grupit të parë, i njerëzve të grupit t'parë nëpër bugjet tjera kroate.

Dhe ne kur kemi shkuar aty, që n'ditën e parë, që n'momentin parë ne jemi nënshtrur një torture tmerrësisht të... t'madhe. Rrahej secili i burgosur. Ka pasur... ishin njerëzit të ri 17, 18 vjeçar, 20 vjeçar, 22, 23 vjeçar, ishte edhe ndonjë i vjetër, po më pak. Gjithsejt nëpër atë burg kanë kaluar më shumë shtatëdhjetepesë t'burgosur politikë shqiptarë, dhe aty kanë ardhur me shërbime mujore njerëz nga t'burgosun kupt... m'falni, kanë ardhur me shërbime mujore gardianë nga e gjithë Kroacia, nga gjitha burgjet e Kroacisë me moton, "Kush donë të rrahë shqiptarë?" Dhe aty ditën dhe natën nuk ka pushuar tortura. Ditën e natën jemi torturuar.

Ka qenë koridori gjashtëdhjetë metra e më tepër i gjatë dhe janë detyru njerëzit që me brushë t'dhambve ta pastrojnë koridorin n'mënyrën ma poshtuese. Kanë marrë batanijën e kanë qitë n'koridor, ni dyshek mbi ma... mbi batanije, një t'burgosur mbi dyshek dhe dy tjerë është dashtë ta tërheqin dyshekun kinse për ta pastruar dhe lustruar mirë koridorin. Do të thotë kjo ka qenë trajtimi që ata na kanë bërë. Me orë të tëra na kanë lanë në kambë. Aty ishte një gardian shqiptar, të cilin asnjëri nuk e njihje dhe i cili quhej Pero, për t'mos u kuptuar se kush është ai, por megjithatë bota është e vogël dhe njerëzit njihen shumë shpejtë dhe ai vinte tek dera, vinte veshin tek vrima n'derë për të degjuar se çfarë po flisim ne dhe për t'na spiunuar tutje. Ai ishte Agim Sejdiu nga rrethi i Istogut, nga... nëse nuk gabohem nga Studenica dhe ai zbulohet rastësisht nga ajo shprehia që shqiptari kur

ta ndezë cigarën...

Ne i pinim cigare, ne ishim duhanxhinjë dhe cigaret nuk na i lenin në... cigaret na i lenin por jo dhe shkrepasat. Nuk i linin shkrepasat dhe kur atyre ju tekej vinin t'na ndeznin dhe në një mbramje kur... hapet dera për ti ndez cigaret, ai ndez cigarën, ishte ai Pero, Agim Sejdiu zvani Pero ose Agim Sejdiu i quajtur Pero dhe ai kur e ndezë cigarën dora i shkon instiktivisht n'zemër edhe një shprehi tek shqiptarët, dhe n'ketë mënyrë, n'ketë mënyrë deko...de..de...dekonspirohet Agim Sejdiu, dekonspirohet se nuk është Pero por është Agim Sejdiu dhe pastaj qarkullonte nga dhoma n'dhomë lajmi, "Pera nuk o..po... Pera nuk o... Pera asht' shqiptar, Pera asht' shqiptar", domethanë t'njoftohen t'burgosurit tjerë, t'kihej kujdes.

Pas dy qindetridhjetepesë ditësh n'atë burg, n'fund kam mbetur fare vetëm, kam dalë me peshë trupore dyzet e gjashtë kilogramë dhe atë i veshur me rroba të dimrit, rroba të burgut të dimrit në të cilat bënin pjesë edhe këpucët e thella dhe të rënda, këpucë... këpucë që përdoren në... nëpër kantieri ndërtimi. Do të thotë, i tillë ishte burgu i Kroacisë [duhet të jetë i Gospiçit, e shtuar me kërkesën e të intervistuarit.] dhe nga burgu i Kroacisë [duhet të jetë i Gospiçit, e shtuar me kërkesën e të intervistuarit.] në dhjetorin e vitit 1982 unë dërgohem po ashtu i lidhur, me tren dërgohem, deri në burgun e Zagrebit dhe nga burgu i Zagrebit pastaj në burgun e Starogradiškës. Aty ishin disa nga ata më t'cilët kishin... kishim qenë në Gospiç bashkë. Po aty e gjejmë edhe simbolin tonë të rezistencës, simbolin tonë të lirisë, Adem Demaçin, dhe në atë burg unë kam qëndruar katër vjet, dhjetë ditë me pak se katër vjet kam qëndruar në atë burg. Një kohë kam qenë edhe në dhomë me Demaçin.

Dhe në atë burg puna ka qenë e detyrueshme për të gjithë të burgosurit. Kushtet e jetesës kanë qenë jashtëzakonisht të këqija, shtretërit shumë të këqinjë, dyshekë të stërvjetëruar, batanie të stërvjetëruara, një papastërti e tmerrshme, dhe do të thotë në kushte dhe rrethana të tilla kanë mbajtur dënimin të rinjtë shqiptarë. Ai ka qenë një burg jo normal, ai ka qenë një burg për recedivistë, dhe në atë burg ka pasë edhe 32 herë të dënuar, një person i dënuar deri në tridhjetë e dy herë, do të thotë nga dy herë deri në 32 herë të dënuar ka pasur në atë burg, dhe n'dhomë nuk ke qenë me një, dy, tre apo katër, por kanë qenë 36, 38 vetë në dhomë. Ka patur nga të gjitha kategoritë që njeriu s'mund t'i marrë me mend. Dhe e vërtetë ishte poshtërim i njeriut, shkelje në mënyrën ma drastike të drejtave qoftë edhe të burgosurit.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishin ato ditët kur ishit në dhomë me Demaçin, po mendoj a majshit najfarë lidhje me shqiptarët tjerë, a e keni pas t'artikulum najfarë qëndrimi politik sa keni qenë mrenda, qysh... qysh e...

Ibish Neziri: Qëndrimi...

Erëmirë Krasniqi: ...Qysh i keni rezistuar krejt ato?

Ibish Neziri: Qëndrimi politik ka qenë i njëjti i pa ndryshuar (kollitet). Falë, secili vetëvetës, bindjes së

tij, nuk ka pasur luhajtje në mes të burgosurish politikë, nuk ka pasur thyerje, nuk ka pasur..., do të thotë të gjithë kanë qëndru stoikisht. Burgu i Staragradiškës nuk ka qenë një burg i zakonshëm, nuk ka qenë një burg për shqiptarë faktikisht përkundër kushteve dhe atyre që i përshkruva ma parë. Burgu i Staragradiškës ka qenë një universitet për shqiptarët, universitet i shëndrruar nga Adem Demaçi dhe vetë të burgosurit, sepse, ne kemi dalur, kemi pasur shëtitje me përjashtim të dimrit. Gjatë dimrit nuk ka pas shëtitje, në repart të punës, në pavijon, ndërkaq gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës kanë qenë shëtitjet e pasdites. Dy herë në ditë, të shtuneve, t'shtuneve dhe të dielave ka pas shëtitje. Dhe gjatë këtyre ditëve ne kemi dalur në shëtitje dhe asnjëherë Adem Demaçin nuk e kemi lanë të shëtiste vetëm. Adem Demaçi ka shëtitur bashkë me neve. Do të thotë, dy-tre me të dhe ato shëtitje kanë qenë shkollë sepse Adem Demaçi ka dhanë spjegime t'ndryshme, ka dhanë sqarime t'ndryshme. Adem Demaçi ka spjeguar. Ato kanë qenë tema. Historia e... shqiptare, gjeografia e atdheut, të drejtat e njeriut, tregime të ndryshme, do të thotë tema të ndryshme nga politika, nga historia, nga sociologjia, nga filozofia, do të thotë nga të marrëdhënjet ndërkombtare.

Të gjitha llojet e temave janë diskutu në burgun e Staragradiškës. Shtypin e përditshëm e ka parapaguar burgu nga një ekzemplar, në të gjitha gjuhët nga një ekzemplar. Edhe "Rilindja" ka ardhur. Por, "Rilindja" ishte zadhënsë e Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës, të cilën sot aq lart e ngrisin, që faktikisht nuk ishte më tepër se një zadhanëse e organeve jugosllave. Ne kemi marrë edhe shtypin, kemi parapaguar...secili nga ne ka pasë t'paktën një revistë të parapaguar. Dhe unë nëse kam lexuar "Dugen", "Intervju", "Nin-in" apo "Ilustrovana Politikën", unë i kam nënvizur artikujt që duhet t'i lexoj secili nga ne, artikujt që ka pas çka lexon njeriu në ta. Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe të tjerët, dhe në këtë i parritshëm ishte Adem Demaçi. Do të thotë ai i nënvizonte të gjithë artikujt me atë moton që mos i lëshoni pa i lexu, me porosinë që mos i lëshoni pa i lexu dhe shtypi kalonte nga dora në dorë. Ne lexonim. Ai ishte i parapaguar, zyrtarisht. Do të thotë edhe vinte legalisht tek ne dhe pastaj ne ia përcjellnim n'shëtitje, i këmbenim me pavjonet tjera gazetat. Por për çudi, t'burgosurit dijnë edhe gjëra tjera t'bajnë dhe ne kemi arrit të kemi edhe një radio në burg.

Radioja është montu e tëra në burg. Ka qenë një kuti kartoni e zakonshme. Kapakët, ato për za dhe ato për stacione i ka pas kapaka të pastave t'dhëmbeve dhe ajo dëgjohej natën me kokë t'mbuluar me batanie, me kokë të mbuluar dëgjohej natën, me kufje në veshë dhe të nesërmen lajmet iu ipeshin shokëve. Unë kam pasë mundësinë ta kem atë radio për kohë të gjatë, dhe fillimisht kur ia përcjellnim lajmet Demaçit, ai i dëgjonte lajmet me kujdes, po pas dy- tre herësh, "Ku i merrni këto lajme?" Pyet, "Ku i merrni këto lajme?" ...dhe Baci nuk rrëhej. Baci duhej me i tregu drejtë. "Bacë e kemi një radio kështu, kështu, kështu"...dhe ai... pastaj... reagimi i tij ishte paksa i ashpër, jo për diçka tjetër por ngase ne i dhimbeshim, sepse thonte, "Po ta zënë radion pastaj do e pësosh keq n'çeli, do denohesh". Mirëpo, kur u bind se ne s'e kem ndërmend për me u dorëzu në atë drejtim, atëherë tha, "Mbajeni! Merrni me rradhë dhe ai që mbanë mend më së shumti le t'a mbajë ai..." Meqë unë e kisha një një muj më heret, e kisha mbajtë më gjatë, isha në rrjedhë të ngjarjeve, kur i raportova për lajmet fola ma shumë, mbase ndoshta edhe sajova ndonji, ndonji llaf më shumë (buzëqeshë), ai më tha, "Mbaje ti radion!"

Erëmirë Krasniqi: Çka raportojshtit në radio?

Ibish Neziri: Po unë e ndëgjoja, e ndëgjoja Tiran... Tiranën e ndëgjoja, e ndëgjoja Tiranën, e ndëgjoja BBC-në, ndëgjoja Zërin e Amerikës edhe do të thotë, i ndëgjoja do të thotë këto radiot e huaja se çfarë thonë për Jugosllavinë. Dhe... do të thotë lajmin e parë që e kemi marrë, lajmin e parë kur është burgosur grupi i Beogradit, një grup i Gjillasit, me 28, ka qenë ajo Françuska shtatë e njohur. Është burgosur për shkak të një platforme, ku e di unë, me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë e me ata, do të thotë këtë lajm ia kam interpretu Demaçit n'mëngjes. Ata janë burgos të shtunën, të shtunën në mbramje është dhanë lajmi, edhe unë të nesërmen në mëngjes, të dielen i kam thënë Demaçit, "Bac, ka ndodh kështu, kështu, kështu" dhe fjalë për fjalë ma thotë, thotë, "Shiko Bac," ai mu m'a thotë një emër tjetër, ai vetëm një herë ma ka thanë emrin tim Ibish, edhe kurrë ma. Ai m'thotë... edhe sot e kësaj dite më thotë "Kërlezhë" [Krlëža]. Kërlezhë është një enciklopedist kroat, dhe ai sot e kësaj dite Kërlezhë më thotë edhe kurrë s'më ka thanë ndryshe. ... edhe m'thotë, "Shiko Kërlezhë, sot Beogradi është duke bërë përpjekje ta ndez zjarrin në Kosovë, po mos harro, ai zjarr ka për t'iu shpërthyer midis Beogradit", dhe unë këtu s'kam çka komentoj sepse të gjithë e dijmë se çka ndodhi më vonë, se çfarë ndodhi me 24 apo 26 mars të '99-tës, do të thotë, n'mes të Beogradit vërtetë shpërtheu zjarri. ... edhe do të thotë ... kështu... Burgu i Staragradiskës për shqiptarët ka qenë një shkollë, ka qenë një universitet të cilin e ka udhëheqë Demaçi.

Erëmirë Krasniqi: A ka vazhdu ai me qëndru aty gjatë kohës kur ju keni qenë aty?

Ibish Neziri: Adem Demaçi, Adem Demaçi, Adem Demaçi ka qëndruar aty, unë e kam lënë aty po n'dhomën numër 28 të pavijonit të katërt të burgut të Staragradiskës ditën që kam dalë nga burgu. Adem Demaçi ka dalë në prill, me 12 ose me 13 prill t'vitit 1990, katër vjet më vonë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me juve pas burgut?

Ibish Neziri: Pas burgut unë përsëri iu bashkova organizatës, por jo ma Frontit të Kuq Popullor, sepse Fronti i Kuq Popullor ishte shkrië bashkë me organizatat tjera, me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare të Shqiptarëve në Jugosllavi, me OMLK-në, Organizatën Marksiste Leniniste të Kadri Zekës. Kjo e para ishte e Jusuf Gërvallës, ishte shkri dhe kishin formuar Lëvizjen Popullore të... Lëvizjen Popullore për Republikën e Shqiptarëve në Jugosllavi, edhe nga ajo kohë unë kam qenë pjesë e asaj organizate. e kam vazhduar aktivitetin tim në kuadër të organizatës, mirëpo shpejt pas shërbimit ushtarak, vetëm katër muj, mirëpo shpejt pas daljes nga burgu jam detyru të shkoj në shërbimin ushtarak, dhe unë mendoj se nuk ka pasur ushtarë ma të vjetër se unë në Jugosllavi, sepse kam qenë 30 vjeçar dhe edhe sekretariati i Mbrojtjes Popullore, Sekretariati Komunal i Mbrojtjes Popullore është detyruar nga UDB-ja, nga sigurimi i shtetit t'më dërgoj ushtar.

Shërbimin ushtarak e kam kryer në Lubljanë, dhe ka qenë një kapitull i veçantë i jetës sime, një kapitull që për çdo ditë ka pas provokime, nga më të ndryshmet, ka pas përpjekje për të inskenuar

ndonjë shkak apo arsye për të më arrestuar sërish. Mirëpo kisha një përvojë të gjatë pas vetës, kisha një kujdes të shtuar dhe jo vetëm që jam kujdesur për vetëvetën, por jam kujdesur edhe për të rinjtë shqiptarë që kanë qenë në shërbimin ushtarak sepse gjatë atyre viteve ka pas shumë shqiptarë të arrestuar, edhe jam kujdes që mos të bahem objekt gjykatash, as une dhe as burgosurit tjerë, as të ushtarët tjerë, më falni, shqiptarë që shërbenin në atë kazermë. Dhe ato kanë kaluar shumë vjet, ishte viti 1987-88 do të thotë nga marsi në mars, dhe edhe sot e kësaj ditë njerëzit me të cilët unë e kam kryer shërbimin ushtarak, me një mënyrë ose tjetër kontaktojnë me mu. Jemi gjithnji në lidhje që nga ajo kohë, sepse na ka lidhë një kohë jashtëzakonisht e vështirë.

Pas daljes nga ushtria, duke e parë se nuk kam gjasë për të gjetur ndonjë punë, kam llogaritur si profesion, e kam llogaritur profesionin e juristit, se në fund të fundit thoja se do t'hapja ndonjë advokaturë edhe kam filluar t'studjoj me korrespondencë në fakultetin juridik. Nuk e kam përfunduar fakultetin juridik dhe kam punuar dhe kam vazhduar aty deri n'vitin 1990. Gjatë asaj kohe një shok me të cilin kam qenë në burg, ka udhëheqë, ai ka qenë jo politikisht, ka qenë diçka për komunikacion nëse nuk gabohem, e ka udhëheq një diskotekë në Prishtinë dhe ai m'ka ofruar, "Zgjedhe punën... këtë mundem me bo, këtë e boj, zgjedhe punën që donë ta bësh në diskotekë, ndaq disko joker (DJ), ndaq çka t'dush". Unë s'dija çfarë t'baja tjetër pos garderobier dhe kam punuar gardorobier gjatë sezonës t'dimrit n'atë diskotekë deri në të '90-tën.

Gjithnjë aktiv në organizatë. Kam udhëhequr me Këshillin e Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës sepse kjo në vazhdimsi e ka ndryshue emrin, derisa e soll vetëm Lëvizja Popullore e Kosovës pas dy... pas vitit 1990. Unë kam qenë udhëheqësi i Këshillit të Rrethit për Pejë i kësaj organizate dhe ne kemi vazhduar përsëri me afishe me parulla me veprimtari t'ndryshme.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë karakteri tash kishte, se jemi në një situatë tjetër politike?

Ibish Neziri: Karakteri i shkëputjes, karakteri i shkëputjes prej Jugosllavisë, karakteri i shkëputjes prej Serbisë dhe do të thotë, Kosova Republikë pastaj filloi t'shihej si një hap drejt bashkimit. Do të thotë shpallja e Kosovës, statusi i Republikës për Kosovën ishtë një hap më afër bashkimit, një hap me afër realizimit të projektit të parë të, apo të programit të parë të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: A e ndjejshit ju rënien e Jugosllavisë?

Ibish Neziri: A e ndjeshit? Jo ne nuk e ndjeshim...

Erëmirë Krasniqi: Po se në të '88-tën veç kanë fillu me ndodh ndryshimet...

Ibish Neziri: Jo, ne nuk e ndjeshim, nuk e ndjeshim, nuk e ndjeshim atë, po ne punonim që ajo t'binte. Këtu filloi rrënimi dhe këtu përfundoi rrënimi i Jugosllavisë, dhe unë e kam zhvillu veprimtarinë në atë

organizatë deri në vitin 1990 e tutje, po në vitin 1990 kam filluar t'punoj në gazetari.

Erëmirë Krasniqi: Në cilën gazetë?

Ibish Neziri: Në Kroaci u ndryshu sistemi, në Kroaci u ndryshun njerëzit, erdhën njerëzit tjerë, erdhën njerëz me t'cilët unë kam qenë në burg dhe njëri nga të burgosurit e burgut të Stara Gradishkës në vitin 1990 e themeloj një gazetë e cila quhej "Hrvatska Danas", jo "Danas", por "Hrvatska Danas". Ajo ka qenë gazeta e parë e pavarur në ish-Jugosllavi në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore dhe ajo angazhohej për konfederalizimin e Jugosllavisë. Redaktori i saj ka qenë Ante Taljančić dhe unë jam angazhuar prej tij për... ta mbuluar me informacione Kosovën, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Në atë gazetë kam shkruar me pseudonimin Jole Mislić. Pastaj kam punuar për gazetën e tjetër kroate, për gazetën e Marko Veselićs, një gazetë partiake e përdyjavshme dhe në këtë gazetë kam botuar me pseudonimin Sokol Nika. Do të thotë edhe për këtë gazetë kam shkruar, do të thotë, për zhvillimet në Kosovë, në Maqedoni, në Shqipëri. Kam disa artikuj t'botuar në të.

Erëmirë Krasniqi: A e raportojshit a qysh?

Ibish Neziri: Urdhëoni!

Erëmirë Krasniqi: A raportojshit, a shkojshit nëpër vendet e ngjarjes apo... ku punojshit?

Ibish Neziri: Po. Njëherë u mbajt në Qendrën Inoformative të Kosovës që udhëhiqet prej LDK-së, u mbajt një farë tribune, u mbajt, edhe u diskutu edhe nuk e di a e patën për qëllim t'ma tërheqin vërejtjen se i kam kritiku shumë edhe ata. Do të thotë, i kam kritiku shumë në atë kohë edhe, a e kishin për t'ma tërhequr vërejtjen apo për t'më luftuar edhe sot e kësaj dite nuk e di... Po e di, po më duket, Ibrahim Berisha dhe Milaz... Milazim Krasniqi, njeri prej atyne dyve e'm mori si shembull, "Ai kolegu..." se unë në atë kohë kam punu për disa, se nuk i përfundova për t'gjitha për t'cilat kam punu, po thotë, "Ne kemi informata nga tereni, së vetëm ai kolegu nga Belgjika, nga është ai, nga Belgjika... a nga është ai, shihet në vendin e ngjarjes, ndërkaq ju t'gjithë tjerët po vini dhe po i pritni raportin që po e lëshojmë në t'u para QIK-ut në ora tre". Unë kam punu pos për këto dy gazeta, kam punu për radio Kopenhagen, Radio Zërin e Kosovës nga Kopenhaga, emisoni në gjuhën Shqipe. Kam punuar për Zërin e Kosovës, gazetë e Lëvizjes Popullore të Kosovës që dilte në Zvicër. Pastaj kam punuar për Radiotelevizionin Australian ABC. Ata e kanë pasur qendrën në Zagreb, qendrën për Evropën Juglindore, edhe për ta kam raportuar kështu që do të thotë...

Pastaj në vitin 1990 e tutje ndryshoi situata ime e punës sepse u angazhova në gazetari mjaft mirë edhe do të thotë isha mirë në situatë. Gjatë kësaj kohe unë kam qenë i ngarkuar nga organizata për kontakte me qeverinë kroate, për t'biseduar për çështje, sepse organizata në t'cilën kam militu ka qenë organizatë e cila të gjitha format i ka pasë në programin e vet, t'gjitha format për çlirim, edhe luftën e armatosur nëse nuk japin rezultate format demokratike, dhe unë kam qenë i ngarkuar për kontakte me qeverinë kroate për t'biseduar për çështjet e armatosjes së shqiptarëve. Nga organizata kam qenë

i ngarkuar dhe unë kam pasur kontakte, kam filluar me Djuro Pericën. Ka qenë kryetari i komisionit republikan, komisionit parlamentar të Kroacisë për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së sigurimit të shtetit. Unë me të kisha qenë në të njëjtin burg për kohë të gjatë. Me të kam filluar kontaktet, kanë kaluar të Janko Bobetko të Zlatko Bobetko e kështu me radhë. Do të thotë kam qenë... Gjithmonë e kam shfrytëzuar... udhëtimet për Zagreb... Kam shkue, do të thotë nën maskën e gazetarit, sepse s'kisha nevojë, por, "Kam për t'u paraqitur në redaksi, duhet t'shkuar një herë në mujt në redaksi", dhe gjithmonë prapa asaj unë kam udhëtuar për Zagreb. Edhe... kështu ka ndodh.

Në vitin 1990 pastaj filloi edhe... në shkurt filloi edhe Aksioni i Pajtimit të Gjaqeve. Këtu du ta jap, ose ta saktësoj diçka që m'ka rastisur, pothuajse gjithmonë ta shoh si... një ... një lajm, ta dëgjoj një lajm, ta lexoj një lajm si jo të sakt. Thonë se pajtimi filloi në Lumbardh. Pajtimi nuk ka filluar në Lumbardh sepse në Lumbardh nuk është pajtue askush. Në Lumbardh, nëse nuk gabohem, atë ditë unë nuk kam qenë në Lumbardh, por në Lumbardh janë nxjerrë shtatë ditë besë, po jo edhe pajtimi. Do të thotë, prandaj në vitin... në shkurtin e vitit 1990 filloi pajtimi. Si shkas ishin demonstratat që ndodhën gjatë gjithë asaj kohe se ndodhën demonstratat '88-tën, protesta e demonstratat '89-tën e '90 e... Unë kam qenë pjesëmarrës në të gjitha demonstratat dhe roli i Lëvizjes Popullore të Kosovës, jo vetëm në Pejë, po gjithkund në Kosovë ka qenë i jashtëzakonshëm në ato... n'organizimin e atyre protestave në mënyrë të drejtë apo të tërthortë. Pastaj ne e dimë të gjithë që edhe me 2 nëntor të vitit 1989 në Kodër të Diellit, këtu në Prishtinë u vranë dy nga militantët ma të mëdhej, dy nga udhëheqësit e Lëvizjes Popullore të Kosovës, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu dhe roli i këtyre njerëzve ka qenë i jashtëzakonshëm n'organizimin e këtyre demonstratave, por njëkohsisht edhe në Aksionin për Pajtimin e Gjaqeve. Do të thotë... për t'mos thanë të gjithë, pjesa më e madhe kanë qenë anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës, e atyre që kanë marrë pjesë në pajtimin e gjaqeve.

Erëmirë Krasniqi: Qysh fillon pajtimi për juve, po mendoj Lëvizja e Pajtimit? Qysh ka qenë kontakti i parë?

Ibish Neziri: Unë nuk mund të flas, unë nuk mund të flas për kontaktin e parë, sepse nuk jam pjesë e kontaktit të parë dhe e asaj pesëshës së parë, nuk jam. Prandaj edhe nuk mund të flas... nuk e di...

Erëmirë Krasniqi: Ju qysh keni ra n'kontakt me Lëvizje?

Ibish Neziri: Po ne jemi ra n'kontakt sepse kanë qenë njerëzit që... Ne jemi njoftë mes veti, e kemi njoftë njëri tjetrin dhe kështu do të thotë pa ndonjë procedurë të veçantë jemi bashkangjitë, pa procedurë, aty nuk ka pas ndonjë procedurë. Ka qenë një organizatë e vullnetit të mirë, ka qenë një grup që u shnëdrro faktikisht në një lëvizje që përsëri, për hirë t'saksisë, për hirë t'vërtetës duhet ta them nuk e banë ate intelektualët e Kosovës. Intelektualët e Kosovës u nxorrën nga kabinetet. Respekt për Anton Çettën! Është njeriu i parë, njeri, njeri që gjithçka meriton, çdo epitete nga më t'mirët e meriton Anton Çetta dhe Anton Çetta është njeriu që e ka thanë gjithmonë, do të thotë, ndoshta është edhe i vetmi që e ka thanë mënyrën ma t'mirë, mënyrën ma t'drejtë, n'mënyrën ma

t'ndershme, "Këte po e bën rinia, jo unë". Do të thotë, njerëzit janë nxjerrë nga kabinetet, intelektualët... edhe Anton Çetta që s'i ka pritë dy fjalë, po meniherë ka dalë dhe është vu n'kry të këtij aksioni. Rinia e ka vu n'kry t'këtij aksioni dhe n'mënyrë brilante i ka shërby dhe e ka udhëheqë këtë aksion Anton Çetta.

Do të thotë janë nxjerrë, intelektualët janë nxjerrë nga zyret. Edhe Zekeria Cana, edhe Mark Krasniqi, edhe Ramiz Kelmendi edhe... Mehmet Halimi iu kanë bashkue rinisë, dhe rinia duke qenë e tillë çfare është, një rini e sinqertë, ajo ka bërë vrapin, ajo ka kryer punën dhe i ka vënë... profesorët i ka vënë përpara dhe ka pasë raste kur janë ngritur ata për ta shtrirë dorën e pajtimit dhe ne ju kemi thanë, "Ju falemnderit shumë, por ju e meritoni një nder tjetër sepse ju jeni ka e bani një akt t'madh, një vepër t'madhe jeni duke bërë, dhe ju si familje... kjo familje, kjo shtëpi meriton që të nderohet nga Anton Çetta. Prandaj, ne do t'vijmë me Anton Çettën këtu, ose do t'vijmë me profesorë tjerë". Kështu ishte me... n'raport me... sepse shpeshherë, përsëri do ta keni dëgjuar edhe ju, intelektualët, e bëri rinia dhe intelektualët i nxori, i vuri n'ballë. Ndërkaq, nëse flasim për atë strukturën e çetës së pajtimit, të veprimtarëve të pajtimit, pjesa dërmuese e tyre kanë qenë t'burgosur politik, kanë qenë të dalë nga burgu, njerëz që kanë vuajtur, njerëz që kanë dhanë prova në situata dhe rrethana t'ndryshme. Prandaj kjo ishte njëra ndër arsytet pse aksioni i pajtimit të gjaqeve ishte i suksesshëm. Arsyeja tjetër është: shqiptarët tradicionalisht janë pajtuar përpara luftërave. Është e njohur, n'kohën e para Lidhjes së Prizrenit kur ka filluar pajtimi i gjaqeve me Binak Alinë e me, me malësorë tjerë që njihet me emrin Islihat dhe janë pajtuar gjaqet, do të thotë përpara asaj periudhe kohore dhe ato që nuk kanë arritur t'i pajtojnë, Sylejman Vokshi e ka marrë n'besë, dhe thotë, "Nga sot..." thotë, "të gjitha gjaqet janë n'besën time dhe kush vret kënd për hakmarrje ka punë me Sylejman Vokshin". Dhe Sylejman Vokshi ka qenë Ministër i Luftës. Ne nuk e kishim një forcë të tillë, nuk e kishim një kapacitet të tillë.

Pjesa e dytë

Ibish Neziri: Është çashtja e strukturës së pjesëmarrësve, do të thotë të gjithë ishin t'burgosur... t'gjithë jo, por pjesa dërmuese ishin të burgosur politikë, njerëz që kishin dhënë prova në situata dhe rrethana nga më t'vështirat, njerëz pjesëmarrës nëpër protesta dhe demonstrata, ishin studentë, ishin anëtarë të familjeve të goditura nga pushteti që... që nuk përtonin, po ditë e natë vraponin në terren. Ka pas raste kur... do të...ishin demonstratat që ndodhën në ato periudha kohore në Kosovë dhe kishte të tillë që thonin, "Unë do të mirrja pjesë në demonstrata me shumë kënaqësi, me shumë dëshirë, por po frigohem me dalë se kemi gjak borxh dhe po frigohem me dalë se mund t'vritem prej hasmit." Ai nuk e kishte, nuk e kishte frigën se do t'vritej prej serbit, se atë s'e bënte mend, por kishte frigën se do t'vritej prej hasmit, por jo edhe prej serbit. Dhe ishin këto ata faktorët që na shtynë të vepronim.

Pastaj, shtypi i Beogradit në mënyrët më t'ultë, në mënyrën më joprofesionale, në mënyrën më ç'njerëzore dilte me...me komente, dilte me raporte se u vranë nga hakmarrja, që po vriten nga hakmarrja, që po vrasin njëri-tjetrin se nuk po i vrasim ne. Dhe këtu filloi, këtu ishin ato... ato arsytet

pse filloi aksioni i pajtimit të gjaqeve, dhe...ky aksion në Beograd shkaktoi shqetësim t'madh. Beogradi u shqetësu prej këtij aksioni. Ky akson zgjoi interesim t'madh tek mediat botërore dhe këtu kanë ardhur, unë këtu u njofta me gazetarët e radiostacionit... e radiotelevizionit Australian të cilët m'angazhuan për, për t'punuar për ta.

Erëmirë Krasniqi: A shkruanit ju për Pajtimin në kohën që ishit lidhur më shumë agjensione televizive...

Ibish Neziri: Po ne raportnim, dhe nuk ka pas agjencion botëror që nuk ka dhanë raporte nga këtu për ato që kanë ndodhë për pajtimet, që po ndodhin, përfshirë edhe Verrat e Llukës, atë pajtimin të Verrat e Llukës, apo atë tubimin në të cilin u mbledhën rreth njëmilion njerëz, tubimin në Rugovë, tubimin në... gjithandej Kosovës, tubimin në Karaqevë edhe tubimet nga ma t'ndryshmet. Do me thënë, gjithandej është raportuar për këto tubime, gjithandej ka pas reportazhe, ka pas komente, ka pasë... për këtë veprimtari. Dhe kjo zgjati për një vjet. Kjo pajtoi... përmbi një mijë gjaqe, i pajtoj, ngatrra e ku ta di unë. Unë këtu, kur flasim për pajtimin e gjaqeve, unë nuk mund të mos i përmend dy raste, ka shumë raste për ta veçuar, mirëpo janë dy paksa më karakteristike.

Në njërën, çohet burri plak 70 vjeç n'kamë menjëherë sa i kemi thanë se jemi nga Kosova. Unë kam vepruar me një ekip servis, në të cilin kanë qenë, po filloj, ka qenë Ramë Buja, ka qenë Bejadin Hasani nga Bujanovci, Agni Dauti dhe Atdhetar, apo Guximtar, jo Atdhetar por Guximtar Labunishti nga Struga, Murat Lumani nga Struga, Sadete Zhitia, motra e Afrim Zhitisë. Ka qenë Rrahman Dini, i cili më nuk është në jetë dhe i cili vdiq nga pasojat e plagëve të luftës, pas lufte vdiq. Një djalë vërtet i mrekullushëm, një, një djalë që sa herë jam takuar me të kam gjetë tek ai diçka të re, virtyte të reja kam gjetë, ish i burgosur politik. Dhe ka qenë pastaj Isuf Halimi në Preshevë, ka qenë Adnan Abdullahu bashkë me t'vëllezërit, me Tahirin edhe me Xhemalin në Tetovë, ka qenë Xhevat Ademi dhe grupi tjetër, grupi tjetër i t'rive nga Tetova, emrat e t'cilëve ma nuk mund t'i mbaj n'mend të gjithë.

Erëmirë Krasniqi: Në cilën zonë keni operu?

Ibish Neziri: Ne kemi operuar... ne kemi qenë ekip servis. Kemi operuar gati si... aty ku kanë qenë rastet ma t'vështira. Në zonën e Llapit, Gollakut... të Gallapit. Pastaj n'disa raste relativisht të vështira, këtu në afërsi të Prishtinës, në disa fshatra të Prishtinës, në Grashticë e të ngjashme. Pastaj kemi vepruar në Preshevë dhe Bujanoc. Gjithë ato fshatra të Preshevës dhe të Bujanovcit i kemi kaluar këmbë. Me ditë të tëra kemi vepruar në Tetovë, në rrethinë të Tetovës deri deri në Gostivar dhe unë nuk maj mend t'na ketë metë ndonjë rast i pa pajtuar ku kemi ndërhyrë. Do të thotë, ne kemi qenë ekipë lëvizëse, kemi lëvizur, nuk kemi qenë të përqendruar me një, me një vend. Pastaj unë e përmenda edhe një rast tjetër sepse unë thashë se shqiptarët gjithmonë, tradicionalisht para luftrave janë pajtuar mes vete. Kishim një rast në të cilin kishin bërë përpjekje t'vazhdushme për t'i pajtuar dy familje dhe ishte e pamundur t'pajtoheshin ato dy familje. Kanë ndërhy njerëz që kanë pasë emër, pleqë, si ju kanë thanë...

Erëmirë Krasniqi: Për çka ishin n'gjak?

Ibish Neziri: Një ngatresë e kishin ata, njëfarë ngatërrese. Nuk ish gjak po varet se si interpretohej. Mund te ishte gjak mund t'mos ishte gjak, por ngatërresa kishte shkuar aq thellë sa s'kishte mundur kush t'i pajtoj. Nji fëmijë i kishte vdekë. Fëmija kishte vdekë dhe dyshohej se fëmija nuk ka vdekë prej vdekjës së natyrshme po është i mbytur, ku di unë... do më thënë kështu nga ky rast. Ne nuk i kemi lypur fajtorët asnjëherë, se po t'i lypnim fajtorët nuk do të pajtonim kënd. Dhe plaku na ikte nga shtëpia, vetëm një herë na ka pritur plaku dhe na ikte nga shtëpia. Gjatë kësaj kohe plaku kishte nxitur t'birin t'dilte dhe ta krynte hakmarrjen, ta vriste kundërshtarin dhe ne... ramë në hall si ta zinim plakun n'shtëpi, se po ta zinim plakun mà ai s'mund të na ikte pastaj, dhe... pregaditja e terenit ndodhi n'këtë mënyrë: Ne dërguam miqtë e plakut ma herët te plaku si mysafirë. Ata shkunë po ne u morëm vesh me ta që kur t'shkojnë, mas ni copë herë ta marrin plakun dhe të dalin t'i shohin fushat, qysh i kanë fushat, tokën si e kanë punu e këto, edhe kur t'vijne, plaku ua çelë derën edhe kur tu'a çelë derën na n'odë, për t'qenë n'odë, mos... do të thotë, plaku m'u ballafaqu me neve mos me pasë ka me ikë. Edhe ashtu edhe ndodhi. Ata kanë dalë, ne kemi shkue, kemi hy n'odë, aty jemi ulë n'odë tu pritë edhe kur kanë ardhë ata me plakun, plaku është stepë, e ka hapë derën dhe kur na ka pa mrenda është stepë. Tash nga t'ia majë? S'ka pasë nga t'ia majë edhe u fut mrenda edhe plaku, me miqë. Ai, djali i plakut ishte me neve në odë aty dhe ne po bisedojmë. Plaku u sikletos shumë edhe u ngrit ni herë në kambë e mori këmishën këtu {tregom me dorë kah gjyksi} edhe e hapi këmishën. Të gjitha pullat i këputi, t'këmishës, edhe tha, "O vramni mu bre, besa u koftë dhanë, falë u koftë!"

Kam ndërhyrë në këtë rast, e kam marrë fjalën edhe kam folë me plakun. N'këtë pajtim kemi qenë... po nisëm prej vetëvetës se është bërë... është bërë traditë të thuhet unë e filani e fisteku, kështu, prandaj edhe unë po them, kemi qenë bashkë me Havë Shalën, Rexhep Kelmendin, Rexhepi është i ndjerë, tani nuk është ma, Et'hem Çekun edhe mendoj ka qenë... edhe Myrvete Dreshaj. Nuk jam i sigurtë për Myrveten, por do të thotë kemi qenë... ne kemi qenë pesë, unë, Et'hem Çeku, Rexhep Kelmendi, Havë Shala. mendoj edhe Myrvete Dreshaj edhe jemi... tu bisedu me plakun, i thotë plaku t'birin, "Çohu bre babë epjau dorën!" Edhe plaku... kur i tha plaku kështu, i biri iu kthy edhe i tha, "Jo, babë, kurrë para teje nuk dal!" Dhe plaku ka provu t'ngritet n'kambë me na dhanë dorën. Nuk ka qenë n'gjendje mu ngritë, nuk ka pasë forcë se i humbi forca plakut edhe une jam ngritë n'kambë i kam ndihmu plakut t'ngritet n'kambë. Plaku ma ka dhanë dorën, m'ka përqafue, ma ka thanë atë fjalën e faljes edhe ia ka plasë vajit... Ne jemi ulë. Plaku ka qajtë me za. Ne jemi ulë pastaj, t'gjithë jemi ulë edhe kur është ulë edhe plaku, djali i plakut, i cili ishte detyru për t'dalë edhe për ta kryer vrasjen, ulet dhe ja puthë të dy komtë babës vet, plakut ia puthë te dy komtë edhe qanë edhe djali edhe ka ikë djali ka dalë nga dhoma. Është kthy pas pesë minutash dhe une sot e kam parasyshtë at skenë kur po e flas ketë.

Është kthy pas pesë minutash edhe ka ra n'dy gjujtë para meje me ni përkulje pothuajse deri n'dyshe me edhe me ni dorë grusht, kështu ma ka vu dorën përpara edhe e ka hapë grushtin {shpjegon me duar se si ka vepruar personi në fjalë}. Kur e ka hapë grushtin i ka lëshu pesë pluma të armës

kallashnikov përpara edhe m'ka thanë, “Merrni këta pluma për Kosovën, për kry të hasmit janë kanë t’bamë gati!” Këtë fjalë ma ka thanë ai djalë, edhe pastaj emocionet e kanë bërë punën e vetë dhe asnjëri nga ne s’ka mund të.. t’i përmbajë lotët. Të gjithë bashkarisht kemi qajtur. Dhe për herë t’parë neve na ka ndodhë që t’shtrohet sofa n’odë edhe t’vije komplet familja, me gra, e me vajza, e me fëmijë e me të gjithë t’ulen në sofër me neve dhe t’hamë darkë. Do të thotë, kjo ishte ajo që unë e kam ndoshta ma t’madhërishten që e kam përjetuar gjatë këtij Aksioni të Pajtimit të Gjaqeve.

Kemi darkuar në atë shtëpi dhe jemi nisur nga aty, kemi shku tek... në rethin e Pejës, në rrethin e Pejës dhe kemi shkuar në familjen ku i falej... ku i bëhej... të cilit i bëhej falja, dhe ai familjar është çu për t’na pre qingj me e festue faljen dhe ne nuk kemi pranue. Do të thotë e kemi blloku, “Jo, ne darkën e kemi kry.” Dhe... nuk... zakonisht nuk hanim aty ku falej, vetëm... ne hanim vetëm te falësit. Mjaftonte një copë bukë me një copë djathë përpara n’sofër edhe një gotë me ujë për neve ishte gjithçka. Edhe ai pyetë për kushtet, “Cilat janë kushtet?” “Po s’ke kushte. Kushtet janë që ti t’rrih burrë i mirë, të mos e provokosh, të mos e gjuash me fjalë, të mos e ngacmosh. Këto janë kushtet, nuk ka kushte tjera!” “Jo, nuk ma paska falë.” “More, ta ka falë, po ne prej tij erdhëm tash.” Tri herë u përsërit e njëjta gja, “Jo, s’ma paska falë,” dhe kur e tha herën e tretë, unë e kam fut dorën n’xhep edhe i kam nxjerrë pesë fishekët edhe ia kam vu përpara n’çergë dhe i thashë, “A po i sheh?” Tha, “Po.” Thashë, “Këta ishin kanë t’përgaditun për ty zotni,” thashë, “ne i murëm me veti,” thashë. “Ne këta i murëm me veti,” thashë, “prandaj ti rri burrë i mirë edhe mos e nguc njerin, mos... n’e pafsh n’rrugë shmangu pak, mos i dil përpara, mos e provoko!” Kur i pau fishekët përpara tha, “Vërtetë,” tha, “ma paska falë,” tha, “se herë... kohët e fundit... herë...ditë e fundit m’ka dalë sa herë n’pritë”, tha, “unë e kam hetu pritën edhe iu kam shmangë, i kam ikë.” Tha, “Vërtetë ma paska falë”, kur i pau fishekët përpara vetës. Do të thotë, janë këto gjana, është kjo ajo, kjo, kjo është ajo, ajo ma madhështorja, kur thotë ai, “Merrni këta pluma për Kosovën, këta për kry të hasmit kanë qenë t’bamë gati.” Kjo do të thotë është një diçka vërtetë e madhe.

Kështu do të thotë asht’. Ka shumë raste. Unë ju meta borxh që nuk i përmena n’atë ekipën lëvizëse, n’atë ekipën servis edhe Abdullah Zhegrovën, nuk e përmena Akile Dedincën, që të dy t’burgosun politik, poashtu, nuk e përmena Fatmir Sopin nga Mramori, diku... nga Zllasha, këtu. Do të thotë, ka qenë kjo ekipë që ka lëvizur poshtë e lartë, që ka lëvizur gjithandej trojeve shqiptare për... për ta çu mesazhin e pajtimit. Kam qenë në Gajre të Tetovës, kam qenë në Çegran të Gostivarit, kam qenë në Novosellë... diku në një fshat të Malishevës kam qenë. Kam qenë edhe n’do fshatra tjera, fotografitë i kam, ama nuk e di tani ku... pastaj kam qenë në n’rreth të Gjilanit diku n’malsi të Gollakut atje që për momentin nuk m’kujtohen emrat e fshatrave, po unë do t’i bëjë fotografitë se i kam fotografitë dhe do t’ua dërgoj fotografitë bashkë me vendin se ku është bërë pajtimi. Kam qenë në Kodrën e Trimave këtu ni pajtim tjetër. Po tubimet e mëdha nuk i kam njeke shumë, nuk... ne ekipa janë nuk i ka njeke shumë tubimet e mdhaja. Ne kemi qenë nëpër... n’terren.

Erëmirë Krasniqi: Po, deshta me ju vetë për Maqedoni, për Gajre dhe Çegran, se p’e kuptoj që në Kosovë njerëzit e kanë falë gjakun për hirë të shqiptarisë, po edhe ma shumë për ni Kosovë pak ma

t'fortë, meqenëse ka pasë përçamje t'mrendshme. Ku e gjejshin njerzit në Maqedoni dhe në Luginë të Preshevës motivin për me falë, a ish i njejt?

Ibish Neziri: I njëjti motiv ishte. Shembull ishte Kosova dhe motivi ishte i njëjtë. Madje, me këtë rast po e përmendi edhe këtë, Gajrën e Tetovës. Universiteti i... Hapja e universitetit të Tetovës për herë t'parë është përmend në Gajrë të Tetovës nga profesori Fadil Sylejmani. Aty është përmend për herë t'parë n'ëndhjetshin dhe ai pesë vjet me vonë u hap.

Erëmirë Krasniqi: E aktivistat qysh, ku i gjejshit, qysh ju... qysh krijoshit rrjet me njerëz prej atyne anëve?

Ibish Neziri: Motivi i afronte njerëzit mes vete, motivi i afronte njerëzit mes vete, vinin njerëzit vetvetiu afroheshin, lajmronin ktu është një rast a keni... unë muj me ndihmu n'këtë rast... edhe n'këtë mënyrë afroheshin njerzit.

Erëmirë Krasniqi: E çfare ishin rastet atje, natyra e rasteve?

Ibish Neziri: E keni fjalën për në...

Erëmirë Krasniqi: Hasmitë...

Ibish Neziri: Po, e keni fjalën për në Kosovë apo për viset tjera?

Erëmirë Krasniqi: Për viset tjera...

Ibish Neziri: Për viset tjera? Po t'ngjashme sikurse në Kosovë. Atje ishte grupi, ta zamë, grupi i Adnan Abdullahut. Ai, gjaku i parë, u fal n'fshatin Qellopek. Edhe aty Adnan Abdullahu me dy vllazërit e tij, pos që u vu vet n'dispozicion, ai e vuni n'dispozicion edhe shtëpinë, e vuni n'dispozicion dhe ne flenim n'shtëpi të Adnan Avdullahut. Ata... ishte formu grupi atje dhe ata i kishin identifikuar rastet se ku janë. Edhe ni tjetër do ta përmend që, që... se fjala po nxjerrë fjalën edhe po shpalosen kujtimet, po në Maqedoni na ndodhi. Ne shkuam për t'kërku ni pajtim. Damtusi kishte qenë polic dhe kur ne shkuam tek familja për të kërku faljen, ai tha, "More," tha, "mu po ma kërkon populli e po ma kërkon Kosova. Për popullin dhe për Kosovën jo veç gjakun e vllait t'vramë po une e fali edhe gjakun e tremdhjetë anëtarve t'familjes që e kam, po ju nuk keni kujt t'ia falni këtë. Nuk keni kuj se si t'ma kërkon mu populli edhe Kosova, po qysh jo more, po qysh s'e jap une për Kosovën? Po shkoni ju shihni dhe n'paqi kuj t'ia falni shkoni e faljani, t'falun je... i falun është prej meje."

Dhe kur shkojmë ai e kishte shtëpinë e rrethuar me një mur, dhe muri i shtëpisë së tij ishte i mbushur përplot parulla në maqedonisht, "Rrnoftë lidhja komuniste e Maqedonisë!", "Rrnoftë..." ai kryetari i Maqedonisë kush kanë qenë ata Mojsov e Gligorov e kush drejtin kanë qenë ata, "Rrnoftë Lidhja Komuniste e Jugosllavisë!" e filan kryetari. Shtëpia e tij ishte e mbushur me të gjitha, me të gjitha kto

parulla. Ishte e mbushur, ishte i mbushur muri i oborrit dhe ne nuk hymë hiç te ai. Nuk hymë, thjeshtë nuk hymë, sepse po t'hynim tek ai e dinim se do t'përfundonim n'polici të Maqedonisë dhe ne u kthym përsëri te ky e i thamë, "Ti mos ndërmerr gjë, jo për atë, se ai nuk e meriton faljen, por për... ti nuk meriton për me... për me... për me pasë barrë një gjak t'pa marrun në shpinë, ti falja popullit të Kosovës". Dhe neve na ka rastisë tjetri.... Janë dy raste tjera që janë përmend, por njëri në Tetovë në të cilin kam qenë vet prezent kur është thanë.... Në Çegran del nana, së cilës i ishte vra i vetmi djalë, dhe thotë, "Vrasësi i djalit tim u pjektë n'xehnet me djalin tim!" Këto janë gjëra madhështore që nuk mund t'i gjeshë te asnjë popull tjetër n'botë.

Erëmirë Krasniqi: E a kishit mujtë me spjegu pse shqiptarët nuk ju kanë qasë ligjit po meno, a a... se p'e vrej që edhe n'zonat tjera që kanë ndodhë [gjakmarrjet], a gjithmonë ka qenë sistemi armiqësor ndaj tyre, ai ligjor?

Ibish Neziri: Sistemi ligjor nuk ka qenë efikas ndaj tyre. Gjaqet, gjakmarrjet kanë qenë të nxitura. Ka ndodhë... janë gjetë që me një pushkë janë vra shtatë persona. Jo një njeri që i ka vra shtatë, po merrju pushka njërit, krye njëni vrasjen, merrju pushka ipju tjetrit prej pushtetit.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, pushteti ka qenë i përfshim?

Ibish Neziri: Do të thotë pushteti ka qenë i përfshier në këto rastë, sepse nuk i ka zgjidhur kontestet dhe njerëzit nuk kanë pasë besim në pushtetin që i zgjidh kontestet. Do të thotë mos funksionimi i ligjit. Ai ka qenë. Mos funksionimi i ligjit në shkallën e duhur ka qenë ajo që i ka shkaktuar t'gjitha këto telashe, nxitja për gjëra t'ndryshme, për vepra t'ndryshme. Do të thotë... Ka ndodhë edhe një rast tjetër, për një ngatrrësë t'vjetër për një ngatrrësë t'vjetër, pjesëtari i familjes t'ngatrruar, kjo ka ndodhë ndoshta njëzetë vjet...ka ndodh njëzet vjet ma herët rasti apo tridhetë vjet ma herët ka ndodhë rasti, i është marrë njeriut pasaporti. I është marrë pasaporti dhe i është thanë, "Dil vrite filanin, edhe dil jashtë." Ai ka qenë me punë në Zvicër. Dy vëllezër kanë qenë me punë në Zvicër. Iu është marrë pasaporti dhe mund të them se kur i është marrë pasaporti me emër, kush ka qenë marrësi i pasaportit dhe nxitësi për ta nxitësi për ta qar njeriun "vrasje. Është person i cili del n'televizion dhe flet sot e shet patriotizëm, një UDB-ash i quajtur Mehmet Loci i Pejës. Mehmet Loci ia ka marrë pasaportin dy vëllezërve, njanit ia ka mbajtur ma gjatë dhe tjetrit më shkurt, dhe tjetrit ia ka mbajtur më gjatë, ma shumë se një vjet ia ka mbajtur pasaportin duke i bërë presion për t'dalë për t'u hakmarrë, për t'u hakmarrë dhe ai që duhet vritej ishte një i burgosur politik.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka ndodhë me të?

Ibish Neziri: Çka ka ndodhë? Ka ndodhë ajo që është dashtë të ndodhte. Njeriu nuk i është nënshtrur presionit. Një vjet ka nejt pa punë, një vjet ka nejt n'shtëpi, një vjet nuk është dorëzu dhe pas një vjeti s'kanë pasë nga t'ia mbajnë... nga t'ia mbajnë dhe ia kanë kthyer pasaportin. Dhe këtë rast njeriu e ka shpalosë në... dhe kjo ka ndodhur në rrethin e Pejës, ka ndodhë, dhe këtë rast... kur është shkue

t'kërkohet falja n'atë familje, nana e atyre djemëve, një gru malësore, taman si thuhet n'atë kuptimin në Dukagjin, thuhet një gru malsore për një gru që vërtetë është gru fisnike, ajo thotë, "Ata janë djemët e mi, unë e fali. Ata janë djemët e mi sepse une ata i kam rritë dhe ata fjalën time nuk e kthejnë n'dysh", dhe pastaj ai djalë thotë, "Unë sikur t'kisha dashtë t'hakmerrem unë kam mund t'hakmerrem dhe t'kem privilegje prej pushtetit se kështu kështu kështu ka ndodhë." Do të thotë, edhe këto i kanë ba, i kanë ba për fat t'keq edhe UDB-asht shqiptarë i kanë ba. E përmenda me emër, dhe atij njeriu që e përmenda tani, Mehmet Locit, unë jam i gatshëm në të gjitha mediumet t'i dalë përballë dhe t'ia dëshmoj këtë, t'i them se, "Ti e ke nxitë filan fistekun ta vras filan fistekun me emër e me mbiemër", dhe t'i tregoj edhe sa gjatë ia ka mbajtur pasaportin. Do të thotë të gjitha strukturat e pushtetit jugosllav kanë lujt rol n'futjen e ngatresave mes shqiptarësh, sepse është e njohur ajo prej kohës së romakëve divide et impera, përçaj dhe sundo, do të thotë këta kështu kanë vepru.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kry nisma e pajtimit, kur u përmbledh aktiviteti.

Ibish Neziri: Po, pas një viti, pas një viti ka përfunduar. Do të thotë pas një viti ka përfunduar. Në shkurt të '91-tës, është mbajtur në fshatin Osek në shtëpinë e njërit që poashtu ka falë gjak, është mbajtur tubimi i fundit, ose i themi tubim ose i themi mbledhje ose i themi kongres, si të doni, po i themi, kështu që nuk e ka pasë një emërtim të veçantë po është majtur takimi i fundit i veprimtarëve të Pajtitimit të Gjaqeve në të cilin është raportuar për t'arriturat gjatë atij viti dhe po n'atë takim është shpallur një aksion tjetër i cili poashtu ka qenë jashtzakonisht i sukseshëm, ka qenë aksioni "Familja Ndhmon Familjen". Po në atë pajtim [duhet të jetë: Po në atë takim. Kjo pjesë është shtuar me kërkesën e të intervistuarit.], domethanë, nga njerëzit që kanë marrë pjesë në Aksionin e Pajtitimit të Gjaqeve dhe këtë aksionin "Familja Ndhmon Familjen", në atë takim e ka shpallë profesori i fakultetit të mjekësisë, Xhevat Hasani nga Prizreni.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na spjegu pak çfarë iniciative ka qenë kjo?

Ibish Neziri: Ka qenë iniciativa familjet e kamura, familjet e kamura t'i ndihmojnë familjet që ballafaqoheshin me varfëri për shkak të largimeve nga puna gjatë vitit 1990 e sidomos familjet e pjesës veriore të Kosovës, të Mitrovicës dhe të asaj zone, sepse ajo ishte një zonë industriale ku u u pushunë nga puna mijëra punëtorë, edhe, do të thotë këtë qëllim e kishte, që t'i mbajë t'fortë që t'mos i nënshtrohen pushtetit, t'mos i nënshtrohen pushtuesit. Unë nuk kam qenë shumë aktiv n'ketë aksion. Ka pasë hidhërime n'mu pse nuk jam aktiv po unë n'atë kohë fillimisht domethanë nuk isha n'atë gjendje, sepse unë isha ballafaqu vet kohë t'gjatë me vështësi financiare, pas daljes nga burgu, nga ato.... Nuk e përmenda më herët. Unë n'atë periudhë kohore, gjatë verave, kam shkuar dhe kam punuar n'fusha të Tuzit. Në kopshtari kam punuar dhe unë nuk mund t'merrja ndonjë familje për ta... për t'i mbajtur, sepse të gjithë... pastaj unë familjarët e mij unë i kisha t'papunë, sepse edhe ne pësuam si të tjerët edhe duhej t'i...ta mbaja familjen që e kisha e për një familje të dytë nuk mjaftonin të ardhurat e mija dhe unë nuk mund t'ia lejoja vetës t'i them dikujt merre filan familjen mbaje, por pa pasë unë vet një familje tjetër për ta mbajtur. Dhe pastaj kishte nga shokët e mi nga

bashkëveprimtarët e mij që u hidhëruan n'mua pse unë nuk jam këtu aktiv, por unë i kisha arsytet e mia që ishin krejtësisht objektive dhe nuk kam shumë informacione për këtë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka qenë...?

Ibish Neziri: Shembulli pajti... do të thotë nëse kthehemi edhe një herë te pajtimet këtu, shembulli më i mirë i asaj vllazërisë fetare, i njerëzve kanë qenë dy emra që meritojnë, përgjithnjë e meritojnë të nderohen, Don Lush Gjergji dhe Bilall Krye... m'falni jo Bilall Kryeziu po Xhevat... Xhevat Kryeziu, Mulla Xhevat Kryeziu, janë dy emra që vërtetë meritojnë... meritojnë respekt t'jashtzakonshëm. Meritojnë nderim përjetë për veprimin e përbashkët, për luftën e përbashkët për përpjekjet e përbashkëta që i kanë, që i kanë bërë në këtë drejtim por edhe me të tjerat.

Erëmirë Krasniqi: Cili ka qenë aktiviteti juaj politik ose jeta juaj mas Pajtimeve?

Ibish Neziri: Unë paralelisht kam ecë, paralelisht kam ecë me pajtimet edhe me organizatën, paralelisht kam ecë me pajtimet dhe me organizatën. Në vitin 1991 kam qenë antarë i grupit..., sepse me ndryshimet politike që u banë në Jugosllavi, me ndryshimet politike që u banë në Kosovë, me rëniën e sistemit socialist atëherë ishte vetëm një parti opozitare, ishte në... Deri në vitin 1990 ishte vetëm një organizim opozitar, ishte... i gjithë kësaj, ishte Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës dhe me daljen e... në skenë të LDK-së, duhet ta them atë që e ndjej dhe atë që mendoj se ashtu është, pak a shumë, u shkaktuan çoroditje, sepse u kriju iluzioni se Kosova do t'shlirohet me paqe dhe me dy gishta, dhe pastaj filloi një... një konflikt i heshtur. Konflikti ishte i heshtur mes këtyre dy subjekteve.

Lëvizja Popullore e Kosovës cilësohej si organizatë e kuqe ose organizatë ideologjike, si organizatë e majtë, e ku ta di unë faktikisht, po ne në asnjë rast dhe asnjëherë nuk e kishim ndërmend t'futemi në konflikt me Shqipërinë, pavarësisht sistemit në Shqipëri, sepse ashtu edhe siç na doli n'fund, ne aty e kishim mbështetjen, aty e kishim kokën, ajo ishte jastek për neve, ajo ishte prehër për neve dhe ne nuk donim t'futeshim n'konflikt me Enver Hoxhën apo me sistemin se është i kuq apo është i majtë apo çfardo [që] është, dhe këtu njerëzit filluan të etiketohen, dhe të gjithë të burgosurit politik pa përjashtim u etiketuan si t'kuq. Një grup i t'burgosurve politik si me zor u muar në Lidhjen Demokratike të Kosovës, por sinqerisht po e them, i bindur se asnjëherë t'vetme besimin nuk u'a falën dhe besim në ta nuk patën, sepse ishin... po e them n'thojza, ato nuk po shihen, por n'thojza po e them, sepse ishin të kuq.

Edhe... unë kam vazhdue aktivitetin tim. Në këtë kohë pak radhët e organizuara ilegale u... dopsuan. Duhej më shumë përpjekje, duhej më shumë punë për t'i mbajtur n'kambë. U kriju grupi i organizimit dhe i riorganizimit në vitin 1991, i cili çoi tek Mbledhja e Tretë e Përgjithshme. Paraprakisht u majt një mbledhje e përgjithshme, deri n'atë kohë ishte OMLK-ja, ishte si organ... si organizatë pararojë e LPRK- së, ishte si... një organizatë ideologjike, organizata marksiste leniniste edhe u majtë në Dabishevc, u majt një mbledhje, në të cilën u vendos që OMLK-ja të mos jetë pjesë, të mos jetë

pararojë e LPRK-së... e LPK-së, domethanë t'mos jetë pjesë... organ pararojë. Ata që dojnë, domethanë, mu shkëputë përfundimisht, domethanë u shkëputën nga çdo lloj ideologjie Lëvizja Popullore e Kosovës, dhe vendimet u morrën në Dabishevc, mbledhje konsultative që u mbajt në Dabishevc dhe momentalisht datën nuk mund ta them se sëm kujtohet data, por ishte muaji shkurt dhe unë e kam këtë datë, e kam të shënuar, i kam shënimet e mia në arkivin tim, dhe pastaj u organizu gjatë vitit 1991.

Edhe grupi i organizimit dhe i riorganizimit për përgaditjen e Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme të Lëvizjes Popullore të Kosovës, Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës dhe unë kam qenë pjesë e atij grupit organizativ. Kam qenë bashkë me Xhavit Hazirin, i cili sot nuk dihet ku është, nuk dihet për fatin e tij, është kidnapuar n'shtatorin e vitit 1998 n'mes të Prishtinës, me Xhavit Hazirin, me Ahmet Haxhiun për t'cilin ma vonë kam bërë një libër monografik, me Emrush Xhemajlin i cili erdhi nga Zvicra me... si përforsim, si ndihmë këtu, me Shaban Mujën, me Ramadan Avdiun, me Azem Sylën dhe emrat tjerë, s'po m'kujtohen krejt kush është, dhe si grup organizimi ne përgaditëm Mbledhjen e Tretë të Përgjithshme të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës e cila u mbajt në natën mes 3 dhe 4 tetorit të vitit 1991, dhe në atë mbledhje u mor vendimi për formimin e një force t'armatosur që për mue është vendim i cili çoi n'themelimin e UÇK-së.

Aty paraqitën... Unë sot po shoh që po paraqitën data të ndryshme e gjëra të ndryshme, por për mue mbetet data e themelimit të UÇK-së, mbetet data kur është marrë vendimi për themelimin e një force t'armatosur dhe kjo ka ndodhur në shtëpinë e Sadri Shalës në Ujëmir të Klinës, në natën mes 3 dhe 4 tetorit, të vitit 1991, në të cilën kanë marrë pjesë delegatë nga të gjitha viset shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia. Ka pasë delegatë edhe nga Plava e Gucia andej ka pasë delegatë edhe nga Struga, nga Kërçova, ka pasë nga Presheva, Bujanovci, nga t'gjitha viset e Kosovës madje edhe nga mërgata ka pasë delegatë në atë mbledhje. Edhe me rezolucion të asaj mbledhje... është dalë themelimi i një force të armatosur. Të nesërmen e asaj dite në orët e hershme të mëngjesit, ose të paraditës, në orët e hershme të paraditës të asaj dite, unë komunikatën për mbajtjen e asaj mbledhje e kam dërgue në redaksinë e atëhershme të "Bujkut" sepse "Rilindja" nuk dilte ma, në redaksinë e atëhershme të "Bujkut" dhe ua kam dorëzuar Dush Gashit dhe Bajram Kabashit.

Unë ua kam dorëzuar dhe ajo komunikatë kurrë nuk është publikuar në "Bujk" apo ndonjë informatë për të. E! Do të thotë është kjo njëra ndër ato veprimtaritë e mija n'kuadër të... n'fushën politike. Pastaj jam pjesëmarrës i Mbledhjes Konsultative, njëra ndër mbledhjet ma t'rëndsishtme të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës që është mbajtur në Kërçovë të Klinës në fshatin... në Kërçovë të Maqedonisë në fshatin Kollarë të Kërçovës. Është një mbledhje që është përfolur shumë në koluare të ndryshme. Edhe n'atë mbledhje kanë marrë pjesë delegatë nga të gjitha... nga e gjithë hapsira gjeografike shqiptare e pushtuar nga ish-Jugosllavia, dhe nga ajo mbledhje po ashtu kam dalë anëtar i grupit t'organizimit dhe riorganizimit i ngarkuar për çështje programore dhe statutare. Po këtë vit është mbajtur...

Erëmirë Krasniqi: Çka ka dalë prej atyne mbledhjeve?

Ibish Neziri: Po vendimi për mbajtjen e Mbledhjes Katërt të Përgjithshme. Edhe ajo ka pasë t'bëjë, do të thotë, sepse gjatë kësaj periudhe kohore gjithmonë jemi goditur edhe nga pushteti, por edhe nga politika legale e Kosovës, legaliste e Kosovës. Jemi goditur n'forma nga ma t'ndryshmet. Unë thashë, ne jemi cilësuar si t'kuq, jemi etiketuar me etiketa që...jo neve por atyne që i kanë lëshuar nuk iu bajnë nderë as sot dhe nuk do t'u banë nderë kurrë, sepse ne kemi qenë njerëz që kemi vënë kokën n'torbë për këtë vend. Në fund t'korrikut nga mbledh... pas Mbledhjes së Tretë t'përgjithshme ka dalë një fraksion i Lëvizjes e arësytet e fraksionit unë tash nuk po i përmendi, por ka dalë një fraksion prej Lëvizjes, është nda një grup që ma vonë ka themelue LKÇK-në dhe në 93-shin, 93-shin...

Pastaj për... pasun arrestime, mirëpo para se t'pasojnë arrestimet n'masë në 93-shin, ne shk... janar, në fund t'janarit, pat një përpjekje për të m'arrestuar mua në Pejë dhe unë ika nga Peja. Në ndërkohë vendbanimin tim e kisha paraqitur në Maqedoni, më shumë për shkaqe objektive sepse prisja gjithmonë që do t'më kerkonin, kisha dokumentacion kroat, të Zagrebit, kisha pasaportë dhe letërnjoftim kreden... kredencialet, isha akreditu si gazetar atje, isha akreditu si gazetar tek Lidhja Demokratike e Kosovës, te Qendra Informativ e Kosovës, QIK që quhej atëhere. Dhe unë ika nga Peja dhe erdha në Prishtinë. Këtu në Prishtinë kam banur me ni anëtar t'organizatës, i cili ishte student edhe ai, student pas mbajtjes së denimit me burg i cili njëkohësisht ishte edhe anëtar i Kryesisë së Këshillit të Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës për rrethin e Pejës. Kam banuar me të, e kam kryer punën time si gazetar, kam lëvizur nëpër Prishtinë me dokumenta të falsifikuara por në Rrafshin e Dukagjinit asnjëhere ditën nuk kam... nuk e kam kalur urën e Klinës dhe sidomos në Pejë nuk kam hyrë ditën dhe gjatë gjithë vitit 1993 unë kam qëndruar n'ilegalitet. Deri në... deri më 3 gusht... deri më 4 gusht kam qëndruar, po them gjysëm ilegal ose gjysëm legal, si t'doni po e marrim, këtu nëpër Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: Kur keni emigru?

Ibish Neziri: Urdhëroni?

Erëmirë Krasniqi: Kur keni emigru?

Ibish Neziri: Kur kam emigru? Tash po e them këtë. Dhe këtu në Prishtinë kam banuar ni kohë në Dragodan dhe pastaj në Taslixhe, në shtëpinë e Avdyl Ramës. Kam banuar po me t'njëtin person dhe me një shok tjetër, i cili po ashtu ishte i burgosur politik, dhe deri me 3 gusht unë e kam kryer punën time prej gazetarit. Aty përfundon puna ime si... puna ime si gazetar, sepse me 3 gusht ndodhën arrestimet e dyta. Më 27 korrik u burgos grupi i LKÇK-së, nëse nuk gabohem datë... në datë, se në grup jo, por vetëm në datë. U burgos grupi i LKÇK-së dhe më 3 gusht u godit edhe Lëvizja, pas mbajtjes së, si thuhej, të Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme, dhe u burgosën një numër njerëzish. U burgos...

Erëmirë Krasniqi: Edhe ju?

Ibish Neziri: Jo une nuk u burgosa se unë isha gjysëm ilegal dhe e kisha një fat që t'mos bija n'pritën e tyre... edhe, atë mëngjes unë nisem prej Taslixhes për t'dalë deri n'qytet. Ne kishim një bazë afër gjimnazit. Ajo ishte një agjensi turistike, agjensi udhëtimesh dhe mu pronari i agjensisë m'tha se nga e hëna do të shkoj për pushime në Ulqin. Edhe, deri sa unë dilja n'qytet nga ana tjetër e rrugës e pashë derën e agjensisë të hapur, dhe pyes veten, thamë, "Po çfarë paska ndodhur, pse s'paska shku Nehati në pushim?" E kaloj rrugën dhe kur afrohem të dera, kur t'afrohem për t'u futur brendë, e shoh mi tavolinë, e shoh atë radion e policisë edhe une n'vend se ta vija kambën n'shcallë edhe t'ngjitesha lartë, e drodha kambën edhe ika, me shpejtësi u largova nga aty, dhe ndërkohë pastaj unë mora vesh për arrestimet që kanë ndodhë, kontakti, njoftimet, mora vesh për arrestimet që kanë ndodhë ishte arrestu ai shoku, ishte arrestu Ahmet Haxhiu, ishte arrestu Xhavit Haziri... Ndërkohë mora informata për arrestime në Ferizaj, për arrestime në Therandë, në Suharekë, për arrestime në Prizren, për arrestime në Vushtrri edhe do të thotë arrestimet veç e përfshinë gjithë Kosovën. Unë nga ky moment nuk kam lëvizur ma. Kur kam telefonuar n'shpi, më është thanë se, është bastisë shtëpia dhe se është marrë vllau. Dhe ashtu edhe kishte ndodhë, do të thotë, vllaun e kanë marrë. Diku dymbëdhjetë-trembëdhjetë herë e kanë marrë në hetuesi.

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë ai, edhe ai në Prishtinë apo anëtarë?

Ibish Neziri: Jo, ai nuk ka qenë anëtar. Ai na ka pritë, na ka përcjellë, na ka pritë, na ka përcjellë, e ka çu naj porosi dikund që nuk ka ditë çka konkretisht po çon, po domethanë direkt n'organizim nuk ka qenë, po edhe nuk ka qenë pa njohuri rreth veprimtarisë sime. Edhe pastaj unë kam kaluar në ilegalitet të thellë. Ma nuk kam lëvizë pa siguri t'madhe, dhe një ditë nga Prishtina këtu, po ashtu n'mënyrë t'organizuar, me dokument, me dokument t'falsifikuar ma, jam nisur drejt Rrafshit të Dukagjinit. E kam mësuar pas lufte, nuk e die kush ka ardhë deri te ato të dhana po m'është thanë se unë kam qenë i përcjellur deri përtej urës së Klinës, nga Prishtina. Kam qenë i përcjellur, edhe kur kemi shkue... kur... Tash kur e kujtoj atë rrugë, mu m'kujtohet mirë që i kemi tejkalu dy, dy kamiona t'mdhaj. I kemi tejkalue. Edhe menihere prej..., pasi i kemi tejkalu ata kamiana, përtej Kline, i kam thanë shoferit i cili e ngiste makinën drejt Dukagjinit, i kam thanë, ktheu në të majtë, këtu", edhe ai ka hy meniherë, ka hy n'tmajtë. Po meqë ishte kthesë, kamianat ishin n'kthesë, përcjellsit që kanë qenë prapa nesh nuk kanë mund të hyjnë në tejkalim, me rrezikue vetvetën, me hy në tejkalim dhe unë nuk kam vazhdu për Pejë por kam hy në t'majtë t'fshatrave. Ata kanë vazhdu tutje për Pejë edhe kur [nuk] na kanë nxanë, kanë alarmue.

Por unë gjithnji, domethanë, i kam njekur rrugët që i kam ditur ato rrugë mirë se i kam kaluar për atë vit kambë, i kam kaluar [në] kambë deri në Deçan sa herë prej Kline edhe kam lëvizë, nga aty kam shku në Raushiq, në.. m'fal, jo në Raushiq, por në Rashiq kam shku, ku ishte njeriu me t'cilin kisha banu në Prishtinë. Ai ishte n'pushime, dhe i cili ishte anëtar i Këshillit të Rrethit, Kryesisë të Këshillit të Rrethit në Pejë, Gani Fetaj, dhe i them... e njoftoj Ganiun se çka ka ndodhë, domethanë, çka duhet me ba edhe çka t'ketë kujdes, po se ku jam duke shkuar, si kam tregu askujt, madje as shoferit. Shoferi m'ka fut deri n'fshatin që asht' dashtë të hy edhe ai, edhe me të jam marrë vesh, ai ka qenë njeri që ka

dashtë vetëm me mu t'punojë edhe me asnjë tjetër. Do të thotë, “Çdo detyrë që ti ma jep, une e kryj, po nuk du t'marr detyra, as t'i raportoj askujt tjetër pos teje”. Ai nuk ka qenë i argu... i organizuar, por ka qenë një njeri që mu m'ka besu shumë edhe ka kry detyrat që unë ia kam dhanë. Edhe atë ditë ishte detyra e fundit që e ka kry prej meje, për të m'çu në Rrafsh të Dukagjinit dhe unë kam shku n'fshatin Beleg.

Aty jam strehu në shtëpinë e Ismet Nezirit. Kam qëndrue edhe për ni kohë dhe pastaj i përcjellur nga shokët e organizatës bashkëveprimtarë t'mi, kam kaluar në Shqipëri. Në këtë rast mendoj se edhe dy emra duhet t'i përmend n'mënyrë që të mos ju mbetem borxh, sepse kam shfrytzue shtëpitë e tyre gjatë qëndrimit në ilegalitet në Prishtinë. Ka qenë Demë Ibërdemaj. Unë me vëlla të Demës jam ulur katër vjet në një bankë, n'gjimnaz. Kemi qenë shokë t'mirë, dhe... jam takuar më të n'vorrim të Esat Mekulit. Në pyetjen se si i kam hallet i kam thanë, “Jam shumë keq, dhe prej momentit në moment jam duke pritur kur po m'gjuhen për t'më arrestu.” “Thirrem mu n'çdo kohë në qet' numër të telefonit”. Dhe ai ka ardh e m'i ka sjellë, se unë banesën time e lëshova, m'i ka sjellë çelësat, dhe unë e kam pasë... e kam marrë... e kam shfrytëzu mas pari banesën e motrës tij. Ata kanë qenë po ashtu n'pushim, për disa ditë aty. Nga aty kam vue kontakt me një shok të fshatit Beleg i cili po ashtu nuk ka qenë i organizuar dhe e kam mbajtur larg organizimit edhe jam taku me të.

Atij i kam thanë, “Shko!” E ia kam dhanë detyrën ku duhet t'shkojë edhe pa i tregu konkretisht, pa e ditë ky konkretisht ky ku duhet t'vie, lidhja ime e organizatës ku duhet t'vie, dhe ai e ka çu, e ka çu porosinë dhe unë kam kalu nga ajo banesë kam kalu në banesën e Demë Ibërdemajt, po në Kodër të Diellit, dhe aty kam nejt për disa ditë. Kur kanë ardhë të Këshillit të Rrethit të Pejës, kanë vu kontakt me mu aty, ka ardhë personi që e ka ditë atë banesë ku asht', pastaj unë menjëherë e kam përcjellë atë person dhe përsëri e kam ndërru banesën, se pas çdo takimi ma s'shumti dhjetë minuta kam nejt n'atë objekt. Pas secilit takim unë kam lëvizë. Nuk kam qëndru në t'njëtin objekt dhe nga aty kam shku jam strehu në shtëpinë e... Ismajli e ka mbiemrin, punon në postë këtu në Dardani, dhe vëllain e ka profesor në Juridik, se s'm'kujtohet emri i tij tash (buzëqeshë). Kam banu në shtëpinë e tij edhe për pak kohë dhe pastaj nga aty kam kalu në Rrafsh të Dukagjinit. Në Rrafsh të Dukagjinit kom nejt n'fshatin Beleg rreth një muj, dhe i përcjellur nga Binak Dina dhe shokë tjerë kam kaluar kufinin dhe kam dalë në Shqipëri, dhe prej Shqipërie, do të thotë, në nëntor të vitit 1993 kam shku në Zvicër. Ky është kapitull i përmbledhur... megjithatë është shkurtë i përmbledhur.

Erëmirë Krasniqi: Me çfarë dokumentacioni prej Shipnisë në Zvicër?

Ibish Neziri: Për në Shqipni unë kam dalë nëpër mal.

Erëmirë Krasniqi: Po, prej Shipnisë në Zvicër?

Ibish Neziri: Për në Shqipni, për në Shqipni, unë s'i kam kërku kërkuje leje kur kam hi as kur kam dalë. Kam kalu malin edhe kur m'burgosën atje, se edhe atje m'kanë burgosë, dhe kur m'burgosën atje ju

thosha, “Unë si kërkoj kuj leje kah bi nëpër toka t’mijat, nëpër ara t’mijat. Këto jonë t’mijat, edhe une i bi kah t’du”. Dhe atje kom kalu me dokument jo t’falsifikum. Me dokumente t’pafalsifikuara por me dokumente origjinale, me ni person që kemi qenë, n’atë kohë kemi qenë, për kah pamja kemi qenë t’ngjajshëm me njëri tjetrin (buzëqesh), e ... për nga sjellja dhe veprimtaritë tash, atëherë kemi qenë e tash ma nuk jemi. Ai është sot n’skenën politike, është në ni pozitë shumë t’lartë. Unë s’po ja përmendi emrin. Analizojeni fytyren time, mund ta gjeni vet, se ashtë fytyrë publike, fytyrë publike, edhe unë... unë me pasaportë të tij kam kalue, kam, kam hyp n’aeroplan pa e ndërru fotografinë, pa kurgjo, kam mrri në Zvicër (qeshë). Edhe në Zvicër, mrenda një kohe shumë t’shkurtë m’është njohur statusi i refugjatit politik dhe atje kam... Çka të them tash?

Erëmirë Krasniqi: E çka ka ndodhë me llegalën?

Ibish Neziri: Atje kam vazhdu me veprimtarinë time përsëri n’organizatë. Kam qenë anëtar i redaksisë së “Zërit të Kosovës”. Kam vazhduar punën në “Zërit të Kosovës”. Kam kry kurse t’ndryshme, kurse integrimi dhe kurse gjuhe. Atje kam udhëheqë në periudhën shkurt 1998 - gusht 1999 e kam udhëhequr emisionin në gjuhën shqipe në “Radio Kanalin K” në Aarau të Zvicrës. Kam qenë udhëheqës, kryeredaktor i emisionit. Një emision ose një, një një, po tamam një emision që ka qenë... me gjithçka ka qenë në krahun e UÇK-së, që ka qenë ni za i vogël i UÇK-së në Zvicër. Pasi ka përfunduar lufta këtu e tutje, atëherë, domethanë s’kam pasë interesim për ta udhëheqë ma atë radio dhe kam e lëshuar. Më vonë kam marrë një radio tjetër, poashtu një emision, një emision tjetër në gjuhën shqipe, “Radio Lora” në Cyrih, është quajtur, dhe aty kam punuar për një dy vjet.

Kam...kry kurse të gjuhës dhe kam fillue të punoj si mësues i gjuhës gjermane në kurse të gjermanishtës për të rritur. Ç’është e vërteta, më shumë e kam mësuar gjermanishtën gjatë kohës sa kam punuar si mësues sesa sa kam qenë vet nxanës, sepse jam skuqë edhe jam turpru t’shkoj përpara nxanësve i papërgatitur. Nxanësit i kam pasë të të gjitha niveleve dhe të të gjitha kategorive, prej nxanësit t’shkollës mesme ose prej nxanësit që ka kry, njeriut që ka kry tetëvjeçaren, prej atij që ka qenë n’shkollë t’mesme deri te njeriu që ka qenë me titullin doktor shkencash, i kam pasë nxansit n’kurse t’gjuhë gjermane dhe ma shumë e kam mësuar gjermanishtën duke qenë si mësues vet. Edhe pas një viti e gjysmë si mësues i... po pas një viti mësues i...si mësues i gjermanishtës, kam kalu si mësues i marrëdhanieve sociale. Kam punue edhe për gjashtë muj tjerë, dhe kam...ka përfundu, projekt ishte...ka përfundu projekti dhe pastaj kam shkuar tek gazeta “Arbeitsmarkt Agenda”, “Agjenda e Tregut të Punës” kur përkthehet në gjuhën shqipe titulli i gazetës, dhe aty kam punuar për një vit si redaktor i rubrikës.

Ka qenë një punë shumë e mundimshme për mua për shkak së është dashur t’punoj jo nandë [nëntë] orë sa ka qenë orari i punës por 18 orë. Unë nuk kam qenë i detyruar t’punoj 18 orë, por për ta arritë nivelin e kolegëve t’mij, për ta arritur nivelin e kolegve t’mij, është dashtë t’punoj ma shumë se ata, dyfish, sepse ata e kanë pasë gjermanishtën gjuhë amëtare, unë nuk e kam pasë, dhe për knaqësinë time, pas një kohe që e kam lëshuar punën në atë gazetë, dhe përkundër insistimit të shefit tim, i cili

ka bërë përpjekje t'mëdha me premtimin se do të më ndihmojë për çka t'kem nevojë aty, unë nuk kam nejt, do të thotë, e kam lëshu punën si... atij i kam thanë se, "Ju mund t'më ndihmoni mu një mujë, dy, tre, gjashtë mujë, por jo gjithë jetën time, mbase pas gjashtë mujsh edhe ju vetë e lëshoni këtë punë e gjeni ndonjë punë më t'mirë dhe shkoni dhe pastaj përsëri m'duhë t'punoj 18 orë n'ditë".

Kan qenë artikuj që janë marrë me problemet e t'hujve në tregun e punës në përgjithsi e me të shqipëtarve n'Veçanti. Do të thotë, për herë t'parë aty janë futë problemet e t'huajve në tregun e punës dhe pas këtu unë kam kalu n'fushën e përkthimit dhe të ndërmjetsimit ndërkulturor. Në ndërkohë jam çertifikuar në këtë fushë, kam qenë i punësuar, dhe pas një periudhe kohore edhe kam diplomue n'fushën, si gjeneratë e parë, n'fushën e përkthimit dhe t'ndërmjetsimit ndërkulturor dhe sot e kam një diplomë t'nivelit federal. Jam në mesin e grupit, në mesin e grupit prej 40 vetëve, prej 40 vetave i diplomuar. Bashkë edhe me dy gra tjera shqiptare, jemi tre shqiptarët e parë që diplomojmë. Unë për fushën e gjermanishtes ato dy gra për fushën e frengjishtes, edhe unë prej asaj kohe punoj..., pjesërisht punoj si përkthyes dhe ndërmjetësues ndërkulturor dhe pjesërisht n'kuadër të një projekti punoj si animator dhe ligjërues në ciklin e lartë shkollor. Është një projekt i inicuar nga Organizata për Ndhimë Refugjatëve, është organizatë e nivelit federal me seli në Bern, është "Schweizerische Flüchtlingshilfe", "Ndhimë Zvicëranë Refugjatëve".

Në kuadër të kësaj punoj si ligjërues dhe si animator pjesërisht. Është projekt që prej tetë vjetësh a nëndë [nëntë] vjetsh vazhdon edhe jam i kyçur edhe në atë projekt. Eh, njëkohsisht unë kam vazhdu punën time në Lëvizje për një periudhë... edhe për një periudhë t'gjatë kohore. Kam qenë pjesë e fondit "Vendlindja thërret" për Aarau dhe rrethinë se kantoni ka qenë pak ma i gjanë. Kam qenë përgjegjës i fondit aty edhe jo vetëm atëherë po edhe sot edhe gjithënjë gaditshmëria ime është n'çdo moment që ta japë llogarinë për secilën qindarkë që ka hy përmes meje n'fond dhe që ka dalë përmes meje. Domethanë, që kanë hy edhe që kanë dalë sa kanë hy dhe sa kanë dalë, ku kanë shku, domethanë, unë jam i gatshëm n'çdo moment, sepse unë e kam dorzu një... mjetet i kam dorzu, një kopje e kam dorzu, një kopje e kam mbajtur për veti. Do të thotë i kam të gjitha dosjet, i kam të krijuara. Kam qenë pjesë e atij fondi, që ndihem shume mirë që kam qenë pjesë e atij fondit, jam përpjekë që ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të mos i lamë pa bukë edhe pa barut edhe... kjo ashtë kështu.

Në anën tjetër, pos punës së gazetarit në këto dy radio, në gazetën "Schweizerische..." këtë... në gazetën "Arbeitsmarkt Agenda" unë kam punuar edhe në gazeta tjera. Kam punue fillimisht deri në mars të vitit 1997, kam punar edhe për gazetën "Bota sot" dhe n'mars të vitit 1997 kur gazeta "Bota sot" e mori teposhtëzën dhe u rreshtue krah atyne që i shkaktun t'gjitha fatkeqsitë në Shqipëri në '97-tën dhe mori një qëndrim që t'i shajë ushtarët e UÇK-së të cilët kishin filluar aksionin qysh...aksionet qysh në '93-shin, unë jam shkputë prej asaj gazete po kam punu për gazetën "Glob". Kam udhëheqë gazetën që nuk ka dalë gjatë për shkaqe objektive, për shkaqe materiale, gazetën e klubeve dhe shoqatave shqiptare në Zvicër, të quajtur "Bashkimi". Kam qenë kryeredaktor i saj. Kam punuar ose kam qenë anëtar i redaksisë së gazetës "Republika" i revistës "Republika", na ka metë mi thanë

“Republika e Sali Kabashit”, që i mungon fatkeqësisht, sot i mungon... fushës së gazetarisë shqiptare shumë ajo gazetë. Kam punuar... nuk po di edhe për çka tjetër, për kë tjetër, po do të thotë nuk kam ndejt. Kam botuar gjashtë libra deri tash. Libri i parë është përmbledhje intervistash n’bashkautorësi që quhet “Spektër shqiptar”. Është n’bashkautorësi me Emrush Xhemajlin dhe intervistat ose librin e hapë intervista me Ukshin Hotin dhe janë politikanë dhe intelektualë edhe nga Prishtina edhe nga Tirana t’përfshirë në atë përmbledhje intervistash.

Erëmirë Krasniqi: Cili është viti?

Ibish Neziri: Viti 1992-93 është...përfundon, fillon me Ukshin Hotin dhe përfundon me Ramiz Kelmendin. Dhe është për çudi për t’i parë opinionet ose qëndrimet e dy ekstremeve në Shqipri për çashtjen e Kosovës, për ta parë ekstremin e djathtë dhe ekstremin e majtë. Që të dytë kur është çashtja e Kosovës, që të dy ekstremet takohen në një pikë për Kosovën. Edhe libri im i dytë është “Fytyra e dhunës mbi Univerzitetin e Tetovës” që është një ë... më shumë është një foto album sepse fotografia flet vetë ma shumë se fjalët, është përmbledhje e atyre ngjarjeve që janë zhvilluar rreth Universitetit të Tetovës në shkurtin e vitit 1995. Kjo është në bashkautorësi me Tahir Abdullahun. Është e botuar në gjuhën shqipe, komentet, legjendat, parathanja, po parathanja dhe legjendat janë botuar në gjuhën shqipe, në gjuhën gjermane dhe gjuhën frenge. Ky libër është shpërnda shumë nëpër institucione t’ndryshme evropiane, gratis.

Libri i tretë është “Ahmet Haxhiu, një Jetë të Tërë në Lëvizjen Ilegale”, është monografi kushtuar Ahmet Haxhiut, i cili për herë të parë u burgos në moshën 14 vjeçare në vitin 1945 dhe për herë të fundit u burgos më 3 gusht të vitit 1993, koha kur unë ika, dhe i cili vdiq më 6 korrik t’vitit 1994. Libri i ... Ky libër është libër që është vlerësu, po thirrrem n’raportet e “Kohës Ditore”. Për një vjet rresht ka qenë në mesin e dhetë librave ma të kërkuara në Prishtinë, ka lëvizur n’mes rendit katër dhe gjashtë. Libri im i katërt është një monografi për Shoqatën Kulturore Shqiptare “Mëmëdheu” e Sankt Gallenit, një shoqatë që vërtetë ka qenë një copë mëmëdhe në Zvicër për shqiptarët. Është monografi e dalë kryesisht nga dokumentet arkivore të saj, një, një, një shoqatë që ka bërë shumë për çështjen shqiptare, që ka bërë shumë për shqiptarët edhe në Zvicër edhe për shqiptarët në Kosovë që edhe sot e kësaj dite është aktuale.

Libri im i pestë asht’ libri... shkolla... është te libri “Vallet në funksion të ruajtjes së identitetit kombëtar”. Është një monografi kushtuar Shkollës Shqiptare të Vallëzimit “Shota” në Zvicër, që është një... ose ka qenë dhe ka mbetë një ambasador i shkëlqyeshëm i kulturës shqiptare në Zvicër, që ka marrë pjesë në shumë manifestime kulturore dhe ndërkulturore, që ka marrë pjesë në disa festivale ndërkombëtare të vallës dhe së fundit ka marrë pjesë edhe në festivalin e Gjirokastrës. Madje pas paraqitjes së saj dhe dy grupeve tjera nga Zvicra, bashkarisht që u paraqitën në skenën e Gjirokastrës, gazetatat të nesërmën shkruanin “Shqiptarët nga Zvicra pushtuan kalanë” dhe unë n’atë shkollë vallëzimi pos që kam bërë, pos që e kam bërë atë monografi për atë shkollë vallëzimi që është në tri gjuhë, në shqip, në gjermanisht dhe në anglisht, unë aty jam edhe këshilltar i drejtuesit të shkollës, i

koreografit të asaj shkolle dhe ajo shkollë ecë, vazhdon me moton “Të mësojmë të ecim shqip”. Edhe ... domethanë tash veç ka kalue njëzet e tri vjet që funksionon kjo shkollë. Është shkollë që i ka nxjerrë më shumë se pesëqindë vallëtarë, do të thotë që i ka nxjerrë... që i ka mësue më shumë se pesëqindë vetë të ecin shqip, veshur me tirç e me veshje nga t’gjitha viset shqiptare burrash e grashë.

Libri im i gjashtë është libri “Këtu jam për t’i luftuar armiqtë - monografi për dëshmorin e kombit Xhemajl Fetahaj“, i cili, përmenda ma herët, ka, ka fillue veprimtarinë e vet para moshës 17 vjeçare dhe e ka përfunduar me 31 maj në Koshare, në llogore të ushtrisë serbe, duke luftuar fyt për fyt me ta, dhe... titulli i librit ka dalë nga vetë thanja e tij në një intervistë radio televizianit gjerman ku në pytjen e gazetarit se, “Pse ti je këtu meqë grun dhe fëmijën tuaj i ke në Gjermani?” Ai thotë, “Këtu jam për t’i luftuar armiqtë.” Ky është libri im i gjashtë i botuar. Dy të pa botuar nuk i përmenda, që rrinë n’sirtar. Njeni është pjesë e kujtimeve të mija 235 ditë në burgun e Gospiçit, “Burgu pjesë e jetës - 235 në burgun e Gospiçit”. Ky rrin në sirtarë të tavolinës prej vitit 1989 i pabotuar.

Dhe është libri i fundit, poashtu i pabotuar është një material arkivor, është “Masakrat Titiste në Kosovë në periudhën 1942- 1951”. Është deklarata e Xhafer Vokshit, i cili ka qenë ministër këtu dhe n’vitin 1949 ikë në Shqipëri. Është deklarata e tij që e jep dhe që sjellë dëshmi shumë interesante për opinionin që ende nuk i din dhe që n’shumë raste ngjarjet edhe keqinterpretohen. Ky libër është i pregaditur në gjuhën origjinale, transliterimi është bërë në standard dhe janë futë të gjitha faqet dhe dokumentet janë futur si faksimil dhe libri do t’përkthehet edhe në anglisht dhe do t’botohet si i tillë. Do të thotë, këto janë. Kam projekte tjera nëpër duar. E kam një arkiv jashtzakonisht të pasur, kryesisht e kam elektronik, por kam edhe në letër.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit!